

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5451
E shtunë, 14 prill 2018
çmimi 0.40 €

98 për qind e zyrtarëve të lartë publikë e deklarojnë pasurinë



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI

Në fazën finale të dialogut Kosova të ketë ekip gjithëpërfshirës

Ish-kryenegociatorja e dialogut me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se Kosova duhet të ketë një delegacion gjithëpërfshirës në fazën finale të këtij procesi. Ajo ka bërë me dije se pjesë e këtij delegacioni duhet të jenë Presidenca, Kuvendi, Qeveria

dhe i gjithë spektri relevant. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka thënë se finalja e këtij dialogu duhet të bazohet në platformën që i është dorëzuar Bashkimit Evropian, pjesë e së cilës është njohja reciproke midis dy

shteteve, demarkacioni i kufirit, dëmshpërblimet, si dhe pasuria që duhet ta trashëgojë Kosova nga ish-Jugosllavia. Ajo ka theksuar se në fazën finale të këtij procesi është shumë me rëndësi që ShBA-ja të jetë pjesë e bisedimeve



Qeveria miratoi Kodin e ri penal

Qeveria e Kosovës ka miratuar të premten Projektkodin e ri penal të Kosovës. Kodi i ri penal thuhet se do të ketë një qasje të re në luftën

kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe dukurive të tjera negative. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë

se me ndryshimin e Kodit Penal janë paraparë dënime të ashpra për keqpërdoruesit e parasë publike



Bejtush Gashi emërohet ministër i Punëve të Brendshme

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka emëruar të premten Bejtush Gashin ministër të Punëve të Brendshme. Gashi ka

genë zëvendësministër në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Është doktor shkence dhe ligjërues në fushën e sigurisë

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GRUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

AKTUALE

**VOUÇIQI: ZGJIDHJA POLITIKE
PËR KOSOVËN NUK DO TË
JETË E LEHTË** F. 2

**VESELI SHKON PËR VIZITË
ZYRTARE NË SLLOVENI** F. 5

**KDI-JA PREZANTON
15 PIKA PËR LUFTIMIN
E KORRUPSIONIT** F. 7

**ÇMIMET E BARNAVE
RREGULLOHEN ME UDHËZIM
ADMINISTRATIV** F. 11

EKONOMI

**NËNSHKRUHET MARRËVESHJA
PËR SIGURINË NË
KOMUNIKACIONIN RRUGOR** F. 9

**DOGANA KONFISKON 450
000 COPË CIGARE** F. 8

KULTURË

**RILINDJA
KOMBËTARE
DHE REXHEP
VOKA** F. 14



Prof. dr. Emin KABASHI

SPORT

**KOK-U, MEMORANDUME ME
KOMUNËN E GJILANIT DHE TË
DARDANËS** F. 18

Vuçiçi: Zgjidhja politike për Kosovën nuk do të jetë e lehtë

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, pas takimit me kancelaren gjermane Angela Merkel, tha se, sa i përket çështjes së Kosovës, për Serbinë nuk do të jetë zgjidhje e mirë dhe aspak e lehtë

BERLIN, 13 PRILL - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiçi, në takim me kancelaren e Gjermanisë, Angela Merkel, tha se, sa i përket çështjes së Kosovës, për Serbinë nuk do të jetë zgjidhje e mirë. "Kompromisi nënkupton që të dyja palët të jemi nga pak të pakënaqur e nga pak të kënaqur, por që nënkupton një të ardhme shumë më të mirë për ne", deklaroi Vuçiçi para gazetarëve në Berlin. Ai ua bëri të qartë qytetarëve se "zgjidhja politike për Kosovën nuk do të jetë e lehtë". Ai në vazhdim tha se biseda me kancelaren Merkel ishte e frytshme dhe e hapur, prandaj jam i kënaqur

me rezultatin e bisedimeve sepse, sipas tij, "kancelarja Merkel respekton dhe kupton mjaft mirë gjendjen në Ballkanin Perëndimor, e cila është e interesuar dhe e angazhuar për paqen e stabilitetin në rajon". Vuçiçi tha se Serbia është e përkushtuar ndaj paqes dhe stabilitetit dhe se çdo konflikt i mundshëm në Ballkan do t'i kthente të gjitha vendet në rajon prapa për 100 vjet. "Do të bëjmë gjithçka të mundur për t'i shmangur tensionet, konfliktet apo destabilizimin e rajonit", tha Vuçiçi. Ndërsa kancelarja Angela Merkel tha se Serbia është vend



i rëndësishëm i rajonit me të cilin Gjermania punon ngushtë. "Serbia ka rol kyç edhe sa i përket Kosovës, edhe sa i përket Bosnjë e

Hercegovinës", tha Merkel pas takimit me presidentin serb, Aleksandar Vuçiçi, në Berlin. Përpara takimit me dyer të mbyllura, Merkeli tha se dëshiro

ron që "këto bisedime t'i kontribuojnë gjetjes së një zgjidhjeje për Kosovën, edhe pse kjo nganjëherë mund të jetë e vështirë".

Fajoni: Kosova ka bërë progres në përmbushjen e kriterëve për vizat

STRASBURG, 13 PRILL - Raportuesja e Parlamentit Evropian për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, Tanja Fajon, i ka dhënë notë pozitive Kosovës sa i përket përmbushjes së kriterëve për liberalizimin e vizave. Në një përgjigje për "Slovenja", Fajoni ka thënë se kur është fjala për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është bërë progres i madh. Megjithatë, Fajoni, në përgjigjen e saj nuk ka folur konkretisht se kur mund të ndodhë liberalizimi i vizave. "Kosova ka bërë progres të madh në përmbushjen e të gjitha kriterëve të BE-së për liberalizimin e vizave. Marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës dhe, sipas informative të mia, një progres i madh është bërë edhe sa i përket luftës



kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar", ka theksuar ajo. Sipas Fajonit, tani Komisioni Evropian duhet ta njohë progresin që është bërë dhe se kjo do të bëhet shumë shpejt. "Sapo të japë Komisioni dritën jeshile, unë do ta vazhdoj procedurën e miratimit në Parlamentin Evropian. Do të jetë thelbësore që ministrat

e BE-së të lëvizin shpejt dhe, po ashtu, unë rreth kësaj do ta bëj më të mirën e mundshme. Nuk kemi më asnjë arsye të mos veprojmë e as kohë të humbim. Qytetarët e Kosovës meritojnë të lëvizin lirshëm në Evropë më shumë se kurrë më parë. Tani e kemi një rast unik që këtë ta bëjmë realitet", ka thënë Fajoni.

Mogherini: Momenti për ndryshime në Ballkan

BRUKSEL, 13 PRILL - Shefja e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, në prag të vizitës në Ballkan, tha se "është momenti për ndryshime pozitive, për arrijen e një përparimi të pakthyeshem drejt BE-së". Mogherini javën e ardhshme do t'i vizitojë Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë, ku do t'i prezantojë raportet e reja vjetore nga Komisioni Evropian për përparimin e këtyre vendeve drejt BE-së. Në prag të vizitës, Mogherini tha se "Ballkani Perëndimor është Evropë dhe do të jetë pjesë e së ardhmes së BE-së". "Është interes i përbashkët dhe përgjegjësi e përbashkët e BE-së dhe e vendeve të rajonit, për të mirën e të gjithë qytetarëve tanë.



Është momenti për ndryshime pozitive, në mënyrë që të arrihet përparim i pakthyeshem kah BE-ja", tha shefja e diplomacisë evropiane. Mogherini së pari do ta vizitojë Tiranën, më 17 dhe 18 prill, ndërsa më pas shkon në Shkup, ku do t'i bashkohet edhe komisionari evropian i Zgjerimit, Johannes Hahn. Turneun ballkanik Mogherini do ta vazhdojë me vizitën në Mal të Zi dhe ndalesa e fundit do të jetë Beogradi, më 19 prill.

Rama sot në Shkodër, PD organizon protestë

TIRANË, 13 PRILL - Pas lajmit se kryeministri Edi Rama pritet të shkojë sot (e shtunë) në Shkodër, Partia Demokratike njofton se ka organizuar një protestë. Në një njoftim të shpërndarë për mediet nga Dega e PD-së në

Shkodër, thuhet se protesta e së shtunës do të mbledhë edhe biznesin e vogël që proteston kundër futjes në skemën e TVSh-së. Në protestën e sotme (e shtunë) PD-ja kërkon sërish lirinë e 11 kuksianëve të arrestuar pas

protestës së dhunshme në Rrugën e Kombit. Edhe kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, ka reaguar për vizitën e Ramës në Shkodër. Vasili ka shkruar se kur Shkodra u përmyt, Rama u fut vrimave dhe shkoi për turizëm,

dhe shtoi se Rama është në vendin e parë për paturpësinë në botë. Ndërkaq, kryeministri Rama ka deklaruar se sivjet do të ketë më shumë turistë në shtetin shqiptar. "Të gjitha hotelet e dhomat e ofruara nga operatorët turis-

tikë, nga Velipoja në Sarandë, janë të prenotuara. Kërkesa ndaj Shqipërisë rritet ndjeshëm vit pas viti. Ndërkohë që punojmë për nxitjen e investimeve të reja, duhet të rrisim patjetër cilësinë në çdo aspekt", tha Rama.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Qeveria miratoi kodin e ri penal

Qeveria e Kosovës ka miratuar të premtën Projektkodin e ri Penal të Kosovës. Kodi i ri penal thuhet se do të ketë një qasje të re në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe dukurive të tjera negative. Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se me ndryshimin e Kodit Penal janë paraparë dënime të ashpra për keqpërdoruesit e parasë publike

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 13 PRILL - Qeveria e Kosovës ka miratuar të premtën Projektkodin Penal të Kosovës. Ky Projektkod është bazuar në tri parime themelore: sundim të ligjit dhe luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar; funksionim të organeve të pavarura për zbatimin e ligjit;

dhe mbrojtje dhe avancim të të drejtave të njeriut.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, e ka vlerësuar si ditë të suksesshme miratimin e këtij dokumenti. "Sot është një ditë e suksesshme e Kosovës, pasi tashmë kemi Kodin Penal që ka qenë më se i nevojshëm. Kjo arritje e tillë konfirmon luftën kundër krimit e korrupsionit", është shprehur Haradinaj.

Kurse ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se ky dokument është në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian si dhe në harmoni të plotë me Kushtetutën vendit. Sipas tij, plotësimet dhe ndryshimet e Kodit Penal të Republikës së Kosovës kanë qëllimin e vetëm, që ta avancojnë sundimin e ligjit, forcimin e institucioneve të pavarura në luftimin e krimit dhe qasjen e drejtë dhe efektive në sistemin e drejtësisë për të gjithë qytetarët, pa dallim.

Tahiri ka theksuar se me ndryshimin e Kodit Penal janë paraparë dënime të ashpra për keqpërdoruesit e parasë publike. "Pra, kemi të bëjmë me një politikë e cila është mjaft ndëshkuese ndaj çdo dukurie

që ndërlidhet me keqpërdorimin e parasë publike. Kodi i ri penal ka të bëjë me zgjatjen e parashkrimit të afateve të lëndëve që lidhen me keqpërdorimin e parasë publike, me avancimin e të drejtave të njeriut. Po ashtu, çështja e terrorizimit është trajtuar në këtë kod, janë 20 nene të reja që e trajtojnë këtë çështje", ka deklaruar Tahiri.

Sipas ministrit Tahiri, këto ndryshime u japin një përgjigje të fuqishme kërkesave për parandalimin e veprave korruptive në nivelin e ushtrimit të detyrës zyrtare.

Ky dokument i ri adreson tri tema të gjëra: masat kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit; masat për promovimin dhe mbrojtjen e të

drejtave të njeriut; dhe masat kundër terrorizimit dhe parandalimin e tij.

Në këtë mbledhje kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për shpalljen me interes të veçantë publik të pronave të paluajtshme, të cilat do të preken nga realizimi i projektit "Ndërtimi i kompleksit rezidencial qeveritar" në zonat kadastrale të Prishtinës dhe të Graçanicës. Po në këtë mbledhje ministri i Financave, Bedri Hamza, ka njoftuar kabinetin qeveritar me situatën financiare dhe të projekteve zhvillimore të Qeverisë. Në prezantimin e tij ai ka përmendur treguesit makroekonomikë zhvillimorë dhe trendët e zhvillimit të tyre që paraqesin rëndësi për zhvillimin e vendit.



Bejtush Gashi emërohet ministër i Punëve të Brendshme

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka emëruar Bejtush Gashin, ministër të Punëve të Brendshme. Haradinaj ka thënë se emërimi i tij në këtë post do t'i sjellë qeverisjes së vendit një cilësi të re. "Ministrit të ri i dëshirova suksese në detyrën e tij dhe

i premtova mbështetjen time të plotë, në shërbim të zbatimit të rendit e të ligjit dhe të sigurisë publike në Kosovë", ka thënë Haradinaj.

Bejtush Gashi ka qenë zëvendësministër në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe është doktor shkence si dhe

ligjërues në fushën e sigurisë. Gashi është emëruar në këtë post pas dorëheqjes së ministrit Flamur Sefaj. Dorëheqjen e Sefajt paraprakisht e kishte kërkuar kryeministri Ramush Haradinaj, pas deportimit të gjashtë shtetasve turq për në Turqi, pa dijeninë e tij.



Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

Në fazën finale të dialogut Kosovo

Ish-kryenegociatorja e dialogut me Serbinë, Edita Tahiri, ka thënë se Kosova duhet të ketë një delegacion gjithëpërfshirës në fazën finale të këtij procesi. Ajo ka bërë me dije se pjesë e këtij delegacioni duhet të jenë Presidenca, Kuvendi, Qeveria dhe i gjithë spektri relevant. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka thënë se finalja e këtij dialogu duhet të bazohet në platformën që i është dorëzuar Bashkimit Evropian, pjesë e së cilës është njohja reciproke midis dy shteteve, demarkacioni i kufirit, dëmshpërblimet, si dhe pasuria që duhet ta trashëgojë Kosova nga ish-Jugosllavia. Ajo ka theksuar se në fazën finale të këtij procesi është shumë me rëndësi që ShBA-ja të jetë pjesë e tavolinës së bisedimeve

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 13 PRILL -

"Epoka e re": Znj. Tahiri, si e shihni fazën finale të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë?

Tahiri: Dialogu po zhvillohet në dy nivele. Në nivelin e parë është zbatimi i marrëveshjeve të pazbatuara, ku Kosova veçse ka filluar ta përmbushë obligimin për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Ndërsa Serbia duhet ta zbatojë marrëveshjen për energjinë, për diplomat, për kadastrën, për hapjen e urës së Ibrit dhe për zhbërjen e strukturave të mbetura paralele. Këto dy zhvillime duhet të shkojnë në një pako. Qeveria e Kosovës duhet të angazhohet që të arrihet një pako e marrëveshjes, në të cilën me data do të përcaktohet se kur Serbia do t'i zbatojë marrëveshjet e pazbatuar. Pra, në mënyrë që Kosova kur ta themelojë Asociacionin, edhe Serbia t'i zbatojë marrëveshjet. Unë një zhvillim të tillë nuk po e shoh, edhe pse delegacionet tona kanë marrë pjesë në Bruksel dy herë. Nuk kam dëgjuar se është arritur një pako strategjike që të mos ndodhë që Kosova ta themelojë Asociacionin, ndërsa Serbia ta vazhdojë sabotimin e zbatimit të marrëveshjeve. Në nivelin e dytë, në fazën përfundimtare të dialogut, duhet të shkohet me një delegacion që ka karakter përfaqësues nga të gjitha institucionet: Presidenca, Qeveria, Kuvendi dhe i gjithë spektri relevant politik. Gjithashtu, të hartohet edhe një platformë për fazën finale të dialogut. Bazën e kësaj platforme ia kam dorëzuar Bashkimit Evropian që njihet si dokumenti i temave për fazën përfundimtare të dialogut.

Çështja e parë dhe kryesore është njohja reciproke midis dy shteteve si zgjidhje e vetme e cila sjellë fqinjësi të qëndrueshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që është çelësi për paqen dhe stabilitetin në rajon. Pastaj është tema e demarkacionit të kufirit,

dëmshpërblimet që Serbia duhet t'ia bëjë Kosovës për gjenocidin dhe dëmet njerëzore, materiale, kulturore sipas së drejtës ndërkombëtare. Ndërkaq tema e fundit është ndarja e pasurisë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, sepse me të drejtën ndërkombëtare Kosova duhet ta trashëgojë pasurinë që i ka takuar nga ish-Jugosllavia meqë ka qenë një prej tetë njësive federale të saj. Kjo platformë mund të pasurohet nga institucionet e tanishme, kurse Kuvendi duhet ta autorizojë delegacionin për pjesëmarrje në fazën finale të dialogut.

"Epoka e re": Sa ka gjasa që ky proces të përmbyllet me njohjen reciproke në mes të dy vendeve, kur kemi parasysh se Serbia është kundër njohjes së pavarësisë dhe e cila po lobon për mosnjohje dhe për tërheqje të njohjeve?

Tahiri: Pavarësia e Kosovës është proces i pakthyesëm. Pavarësia ka lindur nga lufta e popullit të Kosovës, me mbështetjen e fuqishme të ShBA-së dhe të vendeve perëndimore. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka konfirmuar se ligjërisht pavarësia e Kosovës ka qenë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Serbia duhet ta ketë parasysh se bota e fuqishme perëndimore ka njohur dhe e mbështet pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Kosovës. Kur Serbia po e sheh se duhet të mbyllet tema me Kosovën dhe se duhet ta njohë Kosovën nëse dëshiron të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian, ajo ka filluar një lojë të këmbimit të territoreve. Por, një gjë është e rëndësishme, se ne e kemi mposhtur këtë tendencë, duke ua bërë me dije partnerëve ndërkombëtarë, në këtë rast ShBA-së dhe vendeve evropiane, se prekja e kufijve sjellë luftëra në Ballkan. Këto kanë qenë tendencat e Serbisë që u kanë shërbyer ambicieve të Rusisë e cila po përpiqet të zbatojë një agjendë gjeopolitike në Ballkan për ta rritur ndikimin e saj. Rusia duke bërë obstrukcione po synon t'i pengojë vendet e Ballkanit të bëhen



anëtare të BE-së dhe të NATO-s. Por, jam e kënaqur që është rikthyer angazhimi amerikan dhe evropian në Ballkan. Ky rikthim i partneritetit euroatlantik në Ballkan është mesazh i qartë për Serbinë dhe Rusinë që t'i ndalin lojërat destruktive gjeopolitike.

"Epoka e re": Është tejkaluar rreziku për shkëmbim të territoreve?

Tahiri: Këtë e ka provuar Serbia, por unë dhe e gjithë udhëheqja politike e Kosovës e kemi bërë të qartë se jemi kundër. Këmbimi i territoreve nuk mund të bëhet sepse veriu i Kosovës dhe Lugina e Preshevës janë toka shqiptare. Nëse duhet të flitet për kufij në Ballkan atëherë duhet të flitet për të gjithë kufijtë që janë në Ballkan. Prekja e kufijve pjesërisht përmbush appetitet e Serbisë dhe

të Rusisë.

"Epoka e re": Liderët shtetërorë të Kosovës po kërkojnë një rol më të fuqishëm të ShBA-së në këtë dialog. Mendoni ju se përfshirja e ShBA-së do të ishte një garanci për përfundimin më të shpejtë të këtij procesi dhe zbatimin e plotë të marrëveshjes përfundimtare?

Tahiri: Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të përfshira në dialogun e Brukselit që nga dita e parë. Në periudhën e dialogut teknik ata kanë qenë pjesë e tavolinës së bisedimeve, mirëpo edhe kur ka filluar dialogu për normalizim, ShBA-ja është e pranishme jo vetëm në Bruksel, por me të gjitha angazhimet e saj, madje shpesh ka qenë edhe faktori kyç për tejkalimin e mospajtimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe për arritjen e

marrëveshjeve. Mirëpo, duke qenë se po hyjmë në fazën finale të dialogut, besoj se kjo kërkesë ka të bëjë që ShBA-ja të jetë përsëri në tavolinën e bisedimeve. E mbështes një gjë të tillë, sepse është shumë me rëndësi që ShBA-ja të jetë pjesë e tavolinës së bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë krahas Bashkimit Evropian.

"Epoka e re": Kosova ka filluar punën për hartimin e statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Përderisa Qeveria po insiston që ky statut të hartohet në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, Lista Serbe po kërkon që i njëjti të bëhet sipas marrëveshjes së Brukselit, duke insistuar në kompetenca ekzekutive.

Tahiri: Mospajtimi këtu është se

va të ketë ekip gjithëpërfshirës



pala serbe po kërkon kompetenca ekzekutive për asociacionin. Marrëveshja e Brukselit, e bazuar në ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës, e bën të qartë se Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive. Pala e Kosovës kërkon zbatimin e plotë të marrëveshjes duke inkorporuar edhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Kurse pala serbe, presidenti Vuçiq, paraqitet i verbër duke thënë se 'në marrëveshjet e Brukselit nuk përmenden ligjet e Kosovës'. Marrëveshja e Brukselit për Asociacionin në nenin e parë e thotë qartë se Asociacioni do të krijohet në pajtim me ligjet e Kosovës. Si duket Serbia, pas nënshkrimit të marrëveshjes në Bruksel, e ka kuptuar se Asociacioni do të jetë në pajtim me ligjet e Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese e verifikon ligshmërinë e Asociacionit dhe statutit në proces të zbatimit. Pala serbe është përdur për këtë dhe ky pendim ka ardhur sa herë që Kosova ka nisur zbatimin e marrëveshjes për asociacionin. Fillimisht Serbia ndërtoi një mur

me të cilin paralajmëroi se nuk dëshiron rezultate nga dialogu, por ndryshim të kufijve. Pastaj ishte treni provokues, pastaj hyrja ilegale e Gjuriqit në Kosovë. Pra, sa herë që Kosova bën hap për zbatimin e marrëveshjes për asociacionin, Serbia e pengon. Kjo duhet të lexohet si një mosgatishmëri e Serbisë që ta zbatojë marrëveshjen e Brukselit.

"Epoka e re": Në asnjë rrethanë nuk do të ketë kompetenca ekzekutive ky asociacion?

Tahiri: Lufta më e madhe në negociatë në Bruksel ka qenë për dy tema. E para, për marrëveshjen për caktimin e kufirit, marrëveshjen e IBM-it e cila ka mundësuar rikthimin e autoriteteve shtetërore të Kosovës në dy pikëkalimet veriore kufitare në Jarinjë dhe Bërnjakë. Dhe e dyta, që Asociacioni të mos ketë kompetenca ekzekutive. Në të dyja rastet Kosova dhe unë si kryenegociatore kemi qenë plotësisht të suksesshëm. Po të mos ishte kështu, Gjykata Kushtetuese ka mundur ta anulojë marrëveshjen. Ligjet e Kosovës

nuk u japin kompetenca ekzekutive asociacioneve. E kemi Asociacionin e Komunave të Kosovës i cili nuk ka kompetenca ekzekutive. As Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe nuk do të ketë kompetenca sepse nuk e lejojnë ligjet e Kosovës.

"Epoka e re": Cili do të jetë angazhimi juaj tash e tutje në jetën politike? Do të jeni pjesë e delegacionit që do ta udhëheqë fazën finale të dialogut?

Tahiri: Është herët të flitet për këtë gjë. Me rëndësi është të arrihet një gjuhë e përbashkët në mes të spektrit relevant politik për fazën finale të dialogut. Kosova ka nevojë për unitet, jo vetëm për dialogun, por edhe për çështje të tjera që na presin në tavolinë. Me këtë Qeveri të pakicës dhe me këtë situatë ku ka shumë ndasi e mospajtime kemi obligim historik që t'u rikthehemi interesave kombëtare dhe ta gjejmë gjuhën e përbashkët. Sa më unikë që jemi, aq më shumë e arrijmë qëllimin tonë. Qëllimi ynë është që marrëveshja finale e dialogut të jetë njohja reciproke ndërmjet dy shteteve.

Nuk po shoh qeverisje vizionare dhe vendimmarrëse

"Epoka e re": Znj. Tahiri, si e vlerësoni në përgjithësi punën e koalicionit qeverisës?

Tahiri: Nuk po shoh një qeverisje vizionare dhe vendimmarrëse. Edhe kur janë marrë vendimet, shumica prej tyre kanë përfunduar në Gjykatën Kushtetuese. Me vjen mirë që demarkacioni është miratuar sepse ka hapur rrugën për lëvizjen e lirë të qytetarëve në Evropë. Mirëpo, në përgjithësi, nuk po shoh ndonjë kapacitet të kësaj Qeverie përballë përgjegjë-

sive që ka për shtetin dhe qytetarët.

Kemi Qeveri të pakicës, në anën tjetër as opozita nuk e ka shumicën për ta rrëzuar, pra është pat pozicion. Kjo mund t'i zgjasë jetën Qeverisë, por nuk i shërben qëllimeve madhore, si: përshpejtimin të reformave evropiane, krijimit të ushtrisë, obligimeve në luftën kundër korrupsionit dhe të tjera. Këto ditë po shohim ngritjen e aktakuzave ndaj ministrave dhe Qeveria do të duhej të jetë në shërbim të sundimit të ligjit. Nuk

kam parë shumë vendosmëri, por do të shohim çfarë do të sjellë e ardhmja. Po ashtu, nuk më kanë pëlqyer zhvillimet e fundit politike ku asnjëri institucion nuk e merrte përgjegjësinë në dy rastet, kur u dëbuan disa qytetarë turq nga Kosova dhe kur hyri ilegalisht Gjuriqi në Kosovë. Reflekton keq për qytetarët dhe është skandaloze kur asnjë nga krerët e institucioneve, sidomos pjesa ekzekutive, pretendon se finse nuk kanë njohuri për gjërat që ndodhin.

Veseli shkon për vizitë zyrtare në Slloveni

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka udhëtuar të premten për në Slloveni, ku do të marrë pjesë në sesionin e pestë të Asamblesë Parlamentare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC PA) - iniciativë rajonale që u themelua më 2014 si rezultat i bashkëpunimit 20-vjeçar që tregon interesin e qëndrueshëm të parlamenteve të 13 vendeve të Evropës Juglindore për bashkëpunim dhe zhvillim të qëndrueshëm të rajonit. Gjatë pjesëmarrjes në sesionin e sivjetmë të Asamblesë Parlamentare të SEEC PA, kryeparlamentari Kadri Veseli do t'i paraqesë të arriturat e Kosovës dhe progresin e shënuar nga legjislativi kosovar në rrugën e Kosovës drejt integriteteve evropiane. Gjatë qëndrimit në Lubjanë, kryeparlamentari Kadri Veseli do të pritët në një takim të posaçëm nga homologu slloven, kryetar i Asamblesë Kombëtare, Milan Brglez.



Procedohen për në Kuvend emrat e kandidatëve për anëtarë të KShC-së

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sporte, Inovacion dhe Ndërmarrësi ka proceduar për në Kuvend shqyrtimin e vendimit të Qeverisë së Kosovës për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) të Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA).

Në këtë takim i pranishëm ishte edhe ministri i Arsimit, i

Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, i cili ka falënderuar anëtarët e komisionit për kontributin e tyre për hartimin e udhëzimit administrativ për Këshillin Shtetëror të Cilësisë në arsim. Ai ka theksuar se zhvillimet e fundit si, udhëzimi administrativ dhe zgjedhja e listës së anëtarëve të AKA-së, kanë ndikuar pozitivisht kundruall institucioneve ndërkombëtare, si dhe për funksionalizimin e AKA-së.

Ministri Bytyqi ka bërë me dije se selektimi i anëtarëve të KShC-së ka qenë sipas kriterëve të udhëzimit administrativ, të ndara në katër fusha. Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, lista me emra të përzgjedhur për anëtarë të KShC-së: Xhavit Rexhaj, Vjollca Krasniqi, Gazmend Luboteni, Arta Jakupi, Rozafa Lila, Dugagjin Zeka u procedua për në Kuvend.



Hoxhaj e Gashi në Vjenë me agjendë lobimi për liberalizimin e vizave

Kryetari i Parlamentit të Austrisë, Wolfgang Sobotka, gjatë takimit me zëvendëskryeministrin Enver Hoxhaj dhe ministrin e Diasporës për Investime Strategjike, Dardan Gashi, ka theksuar se Austria do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën e integritit evropian, në veçanti në liberalizimin e vizave

"Epoka e re"

VJENË, 13 PRILL - Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj dhe ministri i Diasporës për Investime Strategjike, Dardan Gashi, kanë qëndruar për vizitë zyrtare në Austri. Ata janë pritur në një takim nga kryetari i Parlamentit të Austrisë, Wolfgang Sobotka. Hoxhaj dhe Gashi gjatë takimit me kryetarin e Parlamentit Sobotka kanë falënderuar shtetin austriak për ndihmën që i ka dhënë Kosovës në etapa të ndryshme kohore, si para ashtu edhe pas luftës, sidomos në periudhën pas shpalljes së Pavarësisë.

Dy përfaqësuesit qeveritarë kanë kërkuar mbështetjen e Austrisë për proceset e tanishme nëpër të cilat është duke kaluar Kosova. "Si shteti i fundit

në Ballkan që nuk kemi lëvizjen e lirë në vendet e Schengenit, shpresojmë që tash, pasi kemi përmbushur kushtin e demarkacionit, do ta vazhdoni mbështetjen për ta aplikuar procesin e liberalizimit të vizave edhe për Kosovën. Po ashtu, ne mbështetemi fuqishëm në ndihmën dhe bashkëpunimin tuaj dhe në procesin e integritit të plotë të Kosovës në Bashkimin Evropian", ka thënë zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj.

Ndërkaq kryetari i parlamentit të Austrisë, Wolfgang Sobotka, ka falënderuar dy zyrtarët e lartë të Qeverisë së Kosovës për vizitën dhe ua ka uruar atyre 10-vjetorin e themelimit të marrëdhënieve diplomatike mes dy shteteve.

Sobotka ka premtuar mbështetjen e vazhdueshme të Austrisë për Kosovën në të ardhmen.



"Austria do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën e integritit evropian, në veçanti në liberalizimin e vizave dhe integritimin e Kosovës në Këshillin e Evropës", ka thënë Sobotka. Duke folur për investimet e

kompanive austriake në Kosovë, ai ka kërkuar më shumë siguri për investime në Kosovë.

Rreth kësaj teme ka folur edhe ministri i Diasporës për Investime Strategjike, Dardan Gashi, i cili e ka informuar

kryetarin e parlamentit austriak për ligjin e ri për investime strategjike, duke shprehur kështu përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për t'i mbështetur investimet e huaja me të gjitha mekanizmat të cilat i ka në dispozicion vendi ynë.

MASHT-i zgjedh kryesinë e re të Këshillit të Prindërve të Kosovës

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, në një takim të mbajtur të premtën, ka zgjedhur kryesinë e re të Këshillit të Prindërve të Kosovës, të përbërë nga: Imret Reshiti - kryetar, Drita Vladi - nënkryetare, Drita Sadiku Zraqaku - sekretare dhe Burim Bruçaj - procesmbajtës.

Zëvendësministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Hestet Sahiti, ka folur për rolin e rëndësishëm të Këshillit të Prindërve të Kosovës për

ngritjen e cilësisë në arsim dhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Sahiti ka thënë se aktivizimi sa më i madh i KPK-së do të ndikojë në fuqizimin e rolit të prindërve dhe krijimin e një bashkëpunimi sa më të mirë në mes të nxënësve, mësimit dhe prindërve.

Kryetari i ri i KPK-së, Imret Reshiti, ka theksuar se gjatë punës së tij në këtë detyrë do të angazhohet maksimalisht që zëri i prindërve dhe nxënësve të jetë sa më i

fuqishëm, ndërsa është zotuar se do t'i dërgojë përpara proceset të cilat i ka filluar Këshilli i mëhershëm.

Këshilli i Prindërve të Kosovës përbëhet nga 9 anëtarë, 7 përfaqësues të rajoneve të ndryshme të Kosovës dhe dy përfaqësues të minoriteteve. Ky këshill ka për qëllim ta përkrahë dhe ndihmojë mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në arsimin parauniversitar dhe është kanali kryesor i komunikimit shkollë - komunë - MASHT.



KDI-ja prezanton 15 pika për luftimin e korrupsionit

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka prezantuar të premten 15 pika për institucionet e Kosovës për hapat që duhet të ndërmerren në luftën kundër korrupsionit. Florent Spahija nga KDI-ja ka thënë se këto 15 pika duhet t'i kenë parasysh institucionet e Kosovës, duke filluar nga qeveria, gjykata dhe prokuroria

EPOKA E RE**Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 13 PRILL- Përfaqësuesit e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) / **T r a n s p a r e n c y** International Kosova (TIK) kanë mbajtur të premten një konferencë për media gjatë së cilës kanë paraqitur propozimet konkrete të këtij instituti për institucionet, në lidhje me hapat që duhet të ndërmerren në luftën kundër korrupsionit. Me këtë rast, Diana Metushi-Krasniqi nga KDI/TIK ka theksuar se sa i përket çështjes së korrupsionit dhe luftimit të kësaj dukurie, shteti i Kosovës po shfaq një lloj mosinteresimi karshi kësaj çështje dhe ndërmarrjes së hapave konkretë në këtë drejtim. "Të gjithë jemi dëshmitarë të korrupsionit dhe mungesës së veprimeve konkrete të shtetit në luftën kundër korrupsionit. Ka vite që qytetarët nuk dëgjojnë asgjë më shumë se 'korrupsioni do të luftohet' apo 'ne jemi duke e luftuar korrupsionin' dhe 'kemi ndërmarrë të gjitha veprimet në luftën kundër korrupsionit'. Megjithatë, kur shikon konkretisht se çfarë është bërë për ta luftuar korrupsionin, shih se shteti ynë duket disi i

painteresuar për këtë çështje kaq të rëndësishme", ka shtuar ajo, duke theksuar faktin se kjo çështje mbetet edhe një kriter për liberalizimin e vizave. Kurse Florent Spahija nga KDI/TIK ka prezantuar pikat të cilat KDI-ja propozon, që institucionet e Kosovës duhet të fokusohen që të arrijnë rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit. Ai ka thënë se këto 15 pika duhet t'i kenë parasysh institucionet e Kosovës, duke filluar nga qeveria, gjykata dhe prokuroria. Në pikën e parë të propozimit thuhet se duhet të ndërmerren masa në përfundimin sa më të shpejtë të rasteve të mëdha që kanë të bëjnë me korrupsionin. Ndërkaq në pikën e dytë sugjerohet të merren veprime të menjëhershme nga Prokuroria e Shtetit, për fillimin e hetimeve apo përfundimin e hetimeve në rastet ku dyshohet për korrupsion. "Prokuroria e Shtetit duhet të kujdeset që të sekuestrojë sa më shumë pasuri nga personat që janë të dyshuar për korrupsion kurse gjykata, pasi t'i shpallë aktgjykimet, nëse i gjen fajtorë, atëherë të konfiskojë sa më shumë pasuri të fituar me vepër penale. Konfiskimi i pasurisë është përmendur si dështim i vazhdueshëm i



Kosovës në raportin e progresit", thuhet në propozimet e KDI-së.

Tjetër propozim është edhe dekriminalizimi i policisë dhe vendosja para përgjegjësive të të gjithë zyrtarëve policorë të përfshirë në korrupsion e krim të organizuar. "Detyrimin e subjekteve politike që t'i paraqesin raportet profesionale me të dhëna të sakta në lidhje me financimin e tyre dhe shpenzimet gjatë fushatave zgjedhore si dhe kontrolle të rrepta në deklarimet të cilat i paraqesin ato. Detyrimin e ndërmarrjeve publike të nivelit qendror e lokal që të jenë transparente dhe llogaridhënëse

para publikut. Depolitizimin e të gjitha bordeve të këtyre ndërmarrjeve publike", theksohet në propozimet e KDI-së. Po ashtu, si propozim tjetër i KDI-së është edhe mbyllja ose bashkimi i disa agjencive të pavarura të cilat nuk kanë kurrfarë funksione, pos harxhimit e parasë publike dhe mundësinë për korrupsion. Gjithashtu, ndër pikat e propozuara është që institucionet shtetërore duhet ta fillojnë procesin e vetingut për të gjithë zyrtarët e prokurimit në të gjitha autoritetet kontraktuese që shpenzojnë para publike. Po ashtu, ky institucion propozon hapjen e të gjitha kon-

tratave dhe pagesave që realizohen me para publike. "Lejimi i kontrollit të rreptë në procedurat tenderuese duke ndryshuar qasjen e vlerësimit të ofertave. Lehtësimi i qasjes në informata për gazetarë/shoqëri civile dhe qytetarët e interesuar", është theksuar në pikat e tjera të propozuara nga KDI-ja. KDI-ja e ka ftuar Agjencinë Kundër Korrupsionit të mos bëjë propozime për mbyllje të pjesshme të deklarimit të pasurisë për zyrtarët e lartë, por të merret me forcimin e mekanizmave për verifikimin e pasurisë së deklaruar dhe nxjerrjen e provave materiale për prokurorinë e shtetit.

98 për qind e zyrtarëve të lartë publikë e deklarojnë pasurinë



PRISHTINË, 13 PRILL - Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) ka bërë me dije se mbi 98 për qind e zyrtarëve të lartë publikë e kanë deklaruar pasurinë e tyre në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurisë, duke përmbyllur kështu procesin njëmuor të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë. Në listën e zyrtarëve të lartë publikë kanë qenë të përfshirë 4 737 sish, prej të cilëve 4 651 zyrtarë e kanë deklaruar pasurinë (98.18 për qind). Prej numrit të përgjithshëm të zyrtarëve të lartë publikë që kanë pasur për obligim ta deklarojnë pasurinë, 49 prej tyre e kanë deklaruar pasurinë pas afatit, 6 zyrtarë nuk e kanë deklaruar pasurinë

me arsye, kurse 31 prej tyre deri më tani nuk e kanë deklaruar pasurinë. "Po ashtu, 12 zyrtarë të lartë publikë nuk i kanë dorëzuar formularët e deklarimit të pasurisë gjatë afatit të rregullt vjetor, sepse të njëjtit kanë deklaruar pasurinë në dhjetor të vitit 2017 me marrjen e detyrës në pozitën anëtarit në Kuvendin Komunal respektiv. Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) u bënë thirrje zyrtarëve që janë të përfshirë në listat e publikuara, që në një afat sa më të shkurtër ta kontaktojnë Agjencinë Kundër Korrupsionit në rast se pretendojnë për ndonjë pasaktësi", është thënë në njoftimin e AKK-së.

Mehmeti merr pjesë në konferencën vjetore të Bankës Popullore të Maqedonisë



PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Me moton "Rreth një dekadë pas krizës - drejt ciklit të ri global dhe normalizimit të politikës monetare" po zhvillon punimet konferenca e shtatë vjetore e hulumtimit të organizuar nga Banka Popullore e Maqedonisë. Në panelin e guvernatorëve, në

cilësinë e folësve, po marrin pjesë përveç guvernatorit Mehmeti, edhe guvernatorët e regjionit, si: i Maqedonisë, Kroacisë, Shqipërisë si dhe guvernatori i Bankës së Belgjikës. "Në këtë konferencë po marrin pjesë përfaqësues nga institucionet e politikëbër-

jes dhe bota akademike, me qëllim të vetëm që të mundësojnë një terren për një debat mbi çështjet relevante ekonomike. Ndër pjesëmarrësit janë edhe zyrtarët e lartë të Bankës së Sllovenisë, Polonisë, Çekisë, pastaj të institucioneve financiare, si: FMN, BERZh dhe nga

JVI", është thënë në njoftimin e BQK-së.

Kjo konferencë organizohet tashmë tradicionalisht për ta shënuar përvjetorin e pavarësisë monetare të vendit. Tema e këtij viti në këtë konferencë nxjerr në pah nevojën për të siguruar një përmbledhje të mësimëve që

kanë dalë nga kriza si dhe për t'i përshkruar pasojat dhe nevojat e mundshme për ridizajnimin e politikave dhe për t'i adresuar ato në mënyrë adekuate në mjediset e ndryshme. Punimet e kësaj konference po zhvillohen në Ohër të Republikës së Maqedonisë.

Dogana konfiskon 450 000 copë cigare

Në këtë aksion kanë marrë pjesë një numër i madh i zyrtarëve doganorë, ku janë kontrolluar 10 lokale dhe janë konfiskuar 11 400 copë cigare të llojeve të ndryshme pa banderolë.

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Dogana e Kosovës në dy raste të ndara ka konfiskuar sasi të konsiderueshme të cigareve të kontrabanduara. "Në pikëkalimin kufitar të Hanit të Elezit njësitë e Doganës, së bashku me Policinë e Kosovës, gjatë një operacioni të përbashkët kanë gjetur sasi të konsiderueshme të cigareve të fshehura në kabinën e shoferit të një maune dhe në sirtarë të jashtëm të rimorkios një sasi të duhanit. Pastaj kamioni është dërguar për kontroll të hollësishtëm, në të cilin janë gjetur 50 000 copë cigare", është bërë me

dije në njoftimin e Doganës. Njësitët e anti-kontrabandës kanë ndërmarrë edhe një operacion për cigare dhe produkte të duhanit në qytetin e Podujevës. "Në këtë aksion kanë marrë pjesë një numër i madh i zyrtarëve doganorë, ku janë kontrolluar 10 lokale dhe janë konfiskuar 11 400 copë cigare të llojeve të ndryshme pa banderolë. Gjatë kësaj periudhe raportuese Dogana ka konfiskuar sasi të konsiderueshme të cigareve rreth 450 000 copë cigare si dhe duhan të grirë rreth 200 kilogramë", është thënë në njoftimin e Doganës.



Nënshkruhet marrëveshja për sigurinë në komunikacionin rrugor



Ministrit i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se kjo marrëveshje do të ketë ndikim pozitiv në sigurinë e qytetarëve, duke krijuar kështu standarde të cilat minimizojnë aksidentet dhe fatkeqësitë në komunikacion

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 PRILL - Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka pritur të premtën në takim drejtorin e Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës "Infrakos", Agron Thaçi, përfaqësuesin e Asociacionit Kosovar të Motorizimit (AMRKS), Muhamed Krasniqi dhe majorin e Policisë së Kosovës, Jeton Rexhepi. Me qëllim të sensibilizimit dhe të ngritjes së nivelit të sigurisë në komunikacionin rrugor në Kosovë, ministri Pal Lekaj, bashkë me përfaqësuesit pjesëmarrës në takim, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, duke harmonizuar edhe më shumë tërësinë e të gjitha masave të mundura, për një komunikacion sa më efikas dhe të sigurt. Nga ky takim u tha se kjo mar-

rëveshje mes palëve luan një rol tejet të rëndësishëm për zgjerimin e përmasave të sigurisë.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se kjo marrëveshje do të ketë ndikim pozitiv në sigurinë e qytetarëve, duke krijuar kështu standarde të cilat minimizojnë aksidentet dhe fatkeqësitë në komunikacion. Lekaj ka sqaruar vizionin dhe politikën zhvillimore të Ministrisë së Infrastrukturës. "Ministria e Infrastrukturës ka marrë për obligim të krijojë standard edhe për ndërtimin e infrastrukturës rrugore, por edhe në sinjalistikë dhe ndriçim, të cilat u kanë munguar rrugëve tona. Sot jam mjaft i lumtur që nënshkruam një marrëveshje mirëkuptimi, e cila ka rëndësi për qytetarët, për bartjen e buxhetit dhe nisjen e procedurave për sanimin e gjendjes dhe pikave të dobëta, të cilat mund të përmirësohen me nënkalime në hekurudha", ka

thënë ministri Lekaj, duke shtuar se si Ministri e Infrastrukturës gjatë këtyre tre muajve kanë ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të rritjes së sigurisë në komunikacion. "Kanë përfunduar të gjitha procedurat për ta miratuar Udhëzimin Administrativ për themelimin e Këshillit për Siguri në Trafikun Rrugor, i cili udhëzimi do të miratohet nga Qeveria e Kosovës, po ashtu janë dorëzuar pesë projektligje, për plotësim ndryshim të neneve, të cilat kanë të bëjnë me harmonizimin me ligjin mbi kundërvajtjet në trafik dhe sot, si pjesë e këtyre aktiviteteve, nënshkruam dy memorandume bashkëpunimi, një me Asociacionin Kosovar të Motorizimit, një me ndërmarrjen "Infrakos", ka thënë Lekaj.

Ai ka theksuar se me këta faktorë dhe të tjerë synojnë të mobilizohen për ta arritur objektivin e tyre kryesor, që viti 2018 të jetë vit i sigurisë në trafikun rrugor. "Pra, që ta arrijmë uljen e aksidenteve dhe humbjen e jetëve të njerëzve", ka thënë ministri Lekaj.

Ndërkaq drejtori i "Infrakos"-it, Agron Thaçi, e ka cilësuar këtë iniciativë si shumë fitimprurëse për qytetarët. Ai ka thënë se buxheti i ndarë Ministria e Infrastrukturës është jo shumë i

madh, por mund të shpëtojë jetë njerëzish. "Me këtë synojmë t'i eliminojmë aksidentet me vdekje duke i dhënë rëndësi sigurimit të linjave hekurudhore", është shprehur Thaçi. Edhe përfaqësuesi i Asociacionit

Kosovar të Motorizimit, Muhamed Krasniqi dhe majori i Policisë së Kosovës, Jeton Rexhepi, u zotuan para gazetarëve për përbushjen e obligimeve të tyre karshi kësaj marrëveshje.

Punëtorëve të KEK-ut u dalin pagat me rritje

PRISHTINË, 13 PRILL- Punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) të premtën i kanë marrë pagat me rritje, në shumë prej 100 eurosh, ashtu siç ishte premtuar. Rritjen e pagave e kanë konfirmuar drejtuesit e Sindikatës së Re të KEK-ut si dhe disa punëtorë. Kryetari i

Sindikatës së Re të Korporatës Energjetike të Kosovës (SR KEK), Rafet Osmani, ka konfirmuar për "Telegraf"-in se të gjithë punëtorët e KEK-ut pagat i kanë marrë me rritje. "Punëtorët e KEK-ut pagat i kanë marrë me rritje prej 100 eurosh", ka thënë Osmani.



23 shkolla të Prishtinës i nënshtrohen testit PISA

PRISHTINË, 13 PRILL - Në komunën e Prishtinës ka filluar procesi i vlerësimit ndërkombëtar PISA 2018, proces i cili do të zhvillohet deri më 17 prill.

Drejtorja e Arsimit në Prishtinë, në koordinim me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore, koordinatorët dhe mësimdhënësit e shkollave, ka uruar për një proces të mbarë dhe të suksesshëm.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Prishtinë, Jonuz Salihaj, ka realizuar vizita në institucionet edukativo-arsimore në të cilat po mbahet testi, për t'i

inkurajuar dhe uruar nxënësve suksese.

Në Komunën e Prishtinës këtij procesi të vlerësimit do t'i nënshtrohen nxënësit e 23 institucioneve arsimore publike dhe private. Testi do të organizohet në shkencë, lexim dhe matematikë. "Vlerësimi i tillë do të jetë sa sfidues edhe i dobishëm për sistemin e arsimit të Kosovës, sepse do ta nxjerrë në pah gjendjen reale të arsimit dhe do të na orientojë se ku janë përparësitë dhe dobësitë e arsimit në Republikën e Kosovës", është thënë në njoftimin e Komunës së Prishtinës.



Përkujtohen dëshmorët Dalip Behra dhe Bekim Gashi nga fshati Krushë e Madhe



RAHOVEC, 13 PRILL (ER) - Të premtën, në shënimin e 19-vjetorit të rënies së dëshmorëve Dalip Behra dhe Bekim Gashi nga fshati Krushë e Madhe e Komunës së Rahovecit, është mbajtur tubim përkujtimor. Të pranishëm ishin kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi me bashkëpunëtorë, familjarë dhe bashkëlloftëtarë të dëshmorëve.

Kryetari Latifi ka thënë se Dalip Behra dhe Bekim Gashi me shokë i vunë gjoksin furtunës dhe vendosën të përballen me fatin, duke besuar se e drejta është në anën tonë dhe këtë

luftë duhet ta fitojmë ne. "Përkujtimi për të rënë nuk u shërben atyre. Lufta dhe sakrificat e bijve e bijave të kësaj toke janë shembuj dhe përkushtim. Të rënë për liri janë pasqyra ku duhet të shihemi çdo ditë, çdo orë e çdo çast. Jeta është e shtrenjtë dhe të vdesësh për lirinë dhe mirëqenien e të tjerëve është vendim madhor. Dëshmorët që po i përkujtojmë sot dhe të gjithë ata që vdiqën në rrugëtimin e vështirë për liri janë letërnjoftimi ynë. Na mbetet t'i kujtojmë e nderojmë për sakrificën që ata bënë", ka thënë Latifi.



Promovohet romani 'Nilkon'

PRIZREN, 13 PRILL (ER) - Romani më i ri i shkrimtarit Fate Velaj "Nilkon" është promovuar të premtën në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren. Po këtë ditë është promovuar edhe pjesa e dytë e trilogjisë "Kreuztanne" e këtij autori që është edhe piktor, fotograf, eseist dhe deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Rекtori i UPZ-së, Ramë Vataj, ka theksuar se është nder dhe privilegj për këtë universitet që ta organizojë promovimin e krijimtarisë së një shqiptari, veprat e të cilit flasin shumë. Punën e autorit e vlerësuan lart edhe ushtruesi i detyrës së dekanit të Fakultetit të Filologjisë, prof. dr. Flamur Shala dhe prof. dr. Vjollca Dibra.

OSBE-ja mbajti trajnim për anëtarët e Kuvendit Komunal të Mitrovicës

MITROVICË, 13 PRILL (ER) - Kuvendi Komunal i Mitrovicës, në bashkëpunim me OSBE-në, ka mbajtur trajnim me asamblistët e kësaj komune, lidhur me temën e të qenit anëtar i përgjegjshëm dhe efikas në Kuvendin Komunal. Në këtë trajnim morën pjesë kryesuesi i Kuvendit Komunal të

Mitrovicës, Jeton Ujkani, i shoqëruar me asamblistët komunalë, përfaqësues nga OSBE-ja si dhe Veton Vehapi, zyrtar profesional nacional nga misioni i OSBE-së në Kosovë, i cili e udhëhoqi këtë trajnim. Përfaqësuesi nga OSBE-ja gjatë këtij prezantimi ka folur më gjerë

sisht për programin dhe hartimin e buxhetit komunal si dhe çështjet e tjera me rëndësi të cilat kishin të bëjnë me barazinë gjinore në nivelin komunal.

Temë tjetër e diskutimit ishte edhe shqyrtimi i akteve ligjore dhe marrja e vendimeve për kompetencat e nivelit komunal dhe atij qendror.



Punimet sot lënë pa ujë disa lagje të Prishtinës

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka njoftuar se konsumatorët e lagjes "Mati", zonës qendër, komunës së Graçanicës

me rrethinë, Hajvalisë dhe Çagllavicës, sot (e shtunë), duke filluar nga ora 22:00 e mbrëmjes deri në orën 03:00 të mëngjesit, do të kenë ndërprerje të furnizimit

me ujë të pijshëm. Ujësjellësi i kryeqytetit bën me dije se arsyeja e ndërprerjes së furnizimit me ujë, janë punimet teknike në lagjen "Matiqan" që do të realizo-

hen nga ekipet teknike të ujësjellësit të Prishtinës, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës së rrjetit të ujësjellësit.



Çmimet e barnave rregullohen me udhëzim administrativ

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë të premten se ministria që drejton po kalon nëpër një reformë të madhe institucionale në sektorin e shëndetësisë e cila ka për qëllim të përgjithshëm përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore

**EPOKA
ERE****Arbisa SHEFKIU**

PRISHTINË, 13 PRILL - Në Prishtinë është mbajtur të premten diskutimi publik lidhur me draft Udhëzimin Administrativ për rregullimin e çmimit të barnave. Ismaili ka theksuar se për Ministrinë e Shëndetësisë qëllimi i këtij udhëzimi është i dyfishtë. "Fillimisht tentojmë të rregullojmë dhe krijojmë mekanizma mbrojtës për të gjitha autoritetet kontraktuese të fushës së shëndetësisë për produkte mjekësore, ashtu që çmimet e kontraktuara të jenë korrekte dhe në nivel të një mesatareje rajonale dhe evropiane, si dhe Kosova të mos jetë i vetmi vend ku çmimet e produk-

teve mjekësore të kontraktuara të jenë shumëfish më të larta apo të jenë abuzuese", ka thënë ai.

Ismaili ka shpjeguar se Udhëzimi Administrativ i propozuar për rregullimin e çmimeve për produktet mjekësore përcakton kufijtë e çmimeve të cilat MSh-ja apo autoriteti kontraktues do të lejohet të blejnë. "Për fat të keq, në Evropë, vetëm Kosova dhe Bjellorusia nuk kanë pasur mekanizma për t'i rregulluar çmimet e barnave. Sot të gjithë duhet të jemi krenarë se, duke prezantuar këtë udhëzim administrativ për rregullimin e çmimit të barnave, Kosova do t'i thotë lamtumirë kësaj praktike të keqpërdorimit që ka ndod-



hur", ka thënë Ismaili. Sipas tij, ky udhëzim do të ndalojë këdo që oferton me çmime më të larta se në treg dhe do t'i krahasojë çmimet me vendet e rajonit (Shqipëria, Maqedonia, Kroacia, Mali i Zi), për të parandaluar çdo

lloj abuzimi me çmime. Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thënë se ministria që drejton po kalon nëpër një reformë të madhe institucionale në sektorin e shëndetësisë e cila ka për qëllim të përgjithshëm

përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Rezultatet e këtij Udhëzimi Administrativ pritet të jenë: çmime më të ulëta, barna më shumë, furnizim i qëndrueshëm, kursim i buxhetit dhe jetë më të shëndetshme.

Fillon programi për vizita në shtëpi 'Kujdesi për nëna dhe fëmijë'

MITROVICË, 13 PRILL (ER) - Në Komunën e Mitrovicës ka filluar zbatimin e programit të vizitave shëndetësore në shtëpi për kujdesin e nënës dhe fëmijës, program ky i realizuar nga Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë, si dhe me përkrahjen e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë.

Me këtë rast, nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka vizituar Qendrën e Mjekësisë Familjare tek Ura e Gjakut në Mitrovicë.

Qëllimi i vizitës ishte diskutimi lidhur me implementimin e projektit të vizitave shëndetësore në shtëpi për kujdesin e nënës dhe fëmijës.

Drejtori i Qendrës Kryesore të

Mjekësisë Familjare në Mitrovicë, Vllaznim Hoti, ka bërë me dije se qëllimi i këtyre vizitave në shtëpi për kujdesin e nënave dhe fëmijëve është për të ofruar qasje për të gjithë dhe për ta mbrojtur e përmirësuar gjendjen shëndetësore të nënës dhe fëmijës.

Ndërsa nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, ka thënë se implementimi i këtij projekti tregon për kujdesin që Komuna e Mitrovicës, Ministria e Shëndetësisë së bashku me UNICEF-in, është duke i kushtuar shëndetit të nënave dhe fëmijëve. "Qëllimi i këtyre vizitave shtëpiake të përkujdesit të shëndetit të nënës dhe fëmijës është që të bëhet plotësimi i nevojave të çdo individi, veçanërisht të grave, fëmijëve,



duke ofruar shërbime cilësore", ka thënë Mujka. Edhe zëvendëshefi i Zyrës së

UNICEF-it në Kosovë, James Mugaju, ka thënë se është shumë i lumtur që programi i

vizitave shtëpiake po realizohet edhe në komunën e Mitrovicës.



Prishtina bëhet edhe me një sallë alternative

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Komuna e Prishtinës dhe Ministria e Administratës Publike kanë nënshkruar të premten marrëveshje mirëkuptimi, me qëllim të marrjes në shfrytëzim të përkohshëm të sallës së kinemasë në ndërtesën

Aneks, të njohur më parë si "Salla e Armatës", në rrugën "Brigada e Kosovës". Përmes kësaj marrëveshjeje Komuna e Prishtinës fiton të drejtën për dhënie në shfrytëzim të sallës për palët e treta për ngjarje të ndryshme kulturore, sportive e

rinore. "Në javët e ardhshme do të njoftojmë për shfrytëzimin e kësaj hapësire në bashkëpunim me ideatorët e rikthimit të sallës në hapësirë alternative të kulturës në kryeqytet", është thënë në njoftimin për medie të Komunës së Prishtinës.

Presidenti i përjetshëm i Malit të Zi

Edhe pse është në pushtet prej 27 vjetësh, nesër (e diel) Milo Gjukanoviçi ia mësyn edhe një mandati për postin e presidentit. Sipas anketimeve, ai pritët të fitojë rreth gjysmën e votave, por ende nuk është e qartë nëse do t'i fitojë zgjedhjet që në raundin e parë, apo në të dytin



PODGORICË, 13 PRILL - Në raportin e fundit të OJQ-së Freedom House, e cila synon ta nxisë demokracinë në mbarë botën, Mali i Zi klasifikohet si "pjesërisht i lirë". Aty lulëzon korrupsioni dhe gazetarët kritikë janë nën presion - ky vlerësim i keq përsëritet prej vitesh. Kjo mund të lidhet me faktin se në Malin e Zi prej vitesh nuk ka ndryshime politike: që nga viti 1991, Partia Demokratike e Socializmit (DPS) mbretëron në kryeqytetin e vendit Podgoricë me të fortin Milo Gjukanoviçi në krye, i cili ka qenë herë në krye të qeverisë dhe herë të tjera president i vendit. Më 15 prill Milo Gjukanoviçi është sërish në garë për postin e presidentit. Sipas anketimeve, ai pritët ta fitojë rreth gjysmën e votave, por ende nuk është e qartë nëse do t'i fitojë zgjedhjet që në raundin e parë, apo në të dytin. Opozita malaziasë është mjaft e fragmentarizuar dhe tepër e dobët. Gazetari Tufik Softiqi tha për "Deutschen Welle", se "Milo do të fitojë edhe këtë herë, edhe pse vendi ka nevojë urgjente për një rinim demokratik". Gjukanoviçi është i vetëdijshëm për rëndësinë e lartë simbolike të zgjedhjeve presidenciale. Ai do të tregojë se është ende i pamposhtur. Prandaj dhe flet përsëri për "zgjedhje historike" dhe mbështetet në taktikën e

tij të sprovuar: kritikët e tij janë kundër ekzistencës së shtetit të Malit të Zi dhe lidhjeve të tij me Perëndimin. Ata synojnë dëmtimin e qëllimeve të shtetit, kurse ai garanton vazhdimësinë e shtetit. Këtu kemi të bëjmë me një nacionalizëm të përzgjedhur me kujdes. Ky qëndrim polarizues me mesazhe që lidhen me identitetin i ka sjellë deri tani sukses Gjukanoviçit. Megjithatë Gjukanoviçi është në pushtet prej 27 vjetësh dhe tepër i pasur, në moshën 56-vjeçare ai është tepër i ri për të dalë në pension. Kritikët, nga ana tjetër, thonë se këmbëngulja e tij pas pushtetit mund të ketë arsye shumë praktike - imunitetin. Sepse vetëm imuniteti e mbron atë nga çdo përndjekje penale. Nepotizmi dhe korrupsioni janë të pranishëm kudo në këtë vend të vogël me vetëm 600 000 banorë.

Figura të forta të opozitës së dobët

Nga opozita ka dy kandidatë që mund të jenë të rrezikshëm për Milo Gjukanoviçin. Kandidatja e Partisë Social-Demokratike (SDP), Draginja Vuksanoviçi, është profesore dhe e respektuar universiteti, bukuroshe dhe me biografi pa asnjë të metë. Në

një intervistë për gazetën më të madhe të vendit "Vijesti" ajo deklaroi e sigurt: "Gjukanoviçi rënkon nën peshën e fajëve të tij. Pas tri dekadash në pushtet, e vetmja mundësi për të është 'divide et impera' (përçaj dhe sundo). Për të, të gjithë ata që nuk duan ta plaçkitin vendin bashkë me të janë tradhtarë". Fjalë të forta të një kandidateje, e cila vjen nga një parti që dikur ka qenë për shumë vjet partnere koalicioni e Gjukanoviçit. Kandidati tjetër është Mladen Bojaniçi, ai është ekspert financash dhe konsiderohet si i pakorruptueshëm dhe i ndershëm. Fillimisht ai ishte deputet i partisë së vogël Mali i Zi Pozitiv dhe më pas si deputet i pavarur, sepse partia e tij filloi të ndiqte një kurs pro qeverisë. Sipas anketimeve, ai mund të sigurojë në raundin e parë 35 % të votave. Ai e akuzon ashpër Gjukanoviçin duke deklaruar se "nuk e ka të qartë nëse Gjukanoviçi është në anë të shtetit apo të mafias". Në Malin e Zi presidenti nuk ka pushtet të fortë. Opozita shpreson se në rast se Gjukanoviçi do të tronditet në këto zgjedhje në vend mund të zhvillohen zgjedhje të reja parlamentare dhe të arrihet ndryshimi i pushtetit për të cilin shumëkush ëndërron prej vitesh.

LAJME SHKURT

Haley: ShBA-ja ka prova për sulmin kimik në Siri

UASHINGTON, 13 PRILL - Shtetet e Bashkuara kanë prova se në Siri është kryer sulm me armë kimike, u shpreh ambasadorja amerikane në OKB, Nikki Haley. Sipas analizës së Uashingtonit, tha



Haley të premtën në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, forcat qeveritare të presidentit sirian Bashar al-Assad kanë përdorur armë kimike të paktën 50 herë gjatë konfliktit shtatëvjeçar. Ajo akuzoi presidentin sirian se po përpiqet t'i eliminojë kundërshtarët me këto armë. Këto akte, si dhe sulmi në Salisbury kundër ish-agentit rus, tha Haley, janë përpjekje për t'i kthyer armët kimike në përdorim të rregullt, duke shtuar se komuniteti ndërkombëtar nuk mund ta lejojë një gjë të tillë. Ambasadorja amerikane në OKB akuzoi Rusinë se ka shkatërruar mekanizmat ndërkombëtarë të verifikimit dhe se po ndihmon Sirinë të fshehtë gjurmët, gjë që përbën shkelje të ligjit ndërkombëtar, tha ajo. Haley tha se administrata amerikane po zhvillon mbledhje të njëpasnjëshme për të analizuar situatën dhe përgjigjen e saj ndaj këtij akti. Ajo shtoi se një situatë e tillë kërkon një vendim të peshuar mirë, por pa dhënë hollësi se çfarë opsionesh po diskutohen.

Erdogani: Turqia, negociatore mes Rosisë dhe ShBA-së

ANKARA, 13 PRILL - Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka deklaruar se vendi i tij është në bisedime me ShBA-në dhe Rusinë për ta parandaluar përshtetëzimin e




mëtejshëm të tensioneve në Siri. "Duke diskutuar të gjithë këtë, çështja që ne këmbëngulëm ishte se tensionet në rritje në rajon nuk do të ishin të drejta dhe kriza në rajon duhet të përfundojë me vendosjen e paqes", u tha Erdogan gazetarëve në Stamboll. Presidenti turk bëri me dije se ai ka shkëmbyer pikëpamjet mbi Duomën në Siri me homologun e tij rus, Vladimir Putin. Ai, po ashtu, tha se ka folur me presidentin e ShBA-së, Donald Trump, mbi çështjen e sulmeve kimike në Duma, duke shtuar se Turqia ka një qëndrim të fuqishëm kundër përdorimit të armëve kimike, raporton agjencia turke e lajmeve "Anadolu". Sipas agjencisë së mbrojtjes civile Helmetat e Bardha, regjimi i Bashar al-Asadit është fajësuar për një sulm kimik të së shtunës në Duoma në Gutën Lindore, duke lënë të vranë 78 civilë dhe duke plagosur qindra të tjerë.

Macron bisedon me Putinin për situatën në Siri

PARIS, 13 PRILL - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka shprehur shqetësimet e tij lidhur me përkeqësimin e situatës në Siri. Këto komente ai i ka bërë në një bisedë telefonike me homologun e tij rus Vladimir Putin, ku ka bërë thirrje për më shumë dia-

logme Moskën, kanjoftuar zyra e tij. Macron, i cili të enjten tha se Franca ka dëshmi se regjimi sirian ka përdorur armë kimike në sulmin në Duma, gjithashtu ka shprehur keqardhjen e tij për përdorimin e vetos nga Rusia në

Këshillin e Sigurimit lidhur me këtë sulm. "Presidenti i Republikës ka bërë thirrje që dialogu me Rusinë të shtohet, në mënyrë që paqja dhe stabiliteti të kthehen në Siri", thuhet në njoftimin e zyrës së presidentit Macron.





NJOFTIM

Njoftohen të gjithë aksionarët e Bankës Ekonomike Sh.A., Prishtinë, se Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e Asamblesë së Aksionarëve të Bankës Ekonomike (e 31-ta me radhë) do të mbahet ditën e mërkurë, me datë 25.04.2018, në orën 10:00. Mbledhja do të mbahet në lokalet e Zyrës Qendrore të Bankës Ekonomike, në Prishtinë, Sheshi Nënë Tereza, pn.

Për këtë mbledhje propozohet ky REND DITE:

1. Hapja e mbledhjes

Formimi i kryesisë së punës.

2. Zgjedhja e komisioneve:

- Komisioni verifikues;
- Komisioni zgjedhor;
- Caktimi i procesmbajtësit.

3. Raporti i komisionit verifikues

4. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

5. Shqyrtimi dhe Miratimi i Raportit të Punës së Bordit të Drejtorëve për vitin 2017

6. Shqyrtimi dhe miratimi:

- Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2017
- Raporti i Auditorit të Pavarur për vitin 2017
- Vendimi për miratimin e llogarisë vjetore për vitin 2017
- Propozimi për shpërndarje të dividendës

7. Shqyrtimi dhe miratimi/verifikimi i vendimeve të Bordit të Drejtorëve për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Bankës Ekonomike në mes të dy mbledhjeve vjetore të Asamblesë së Aksionarëve.

8. Zgjedhja e auditorit të pavarur për auditimin e pasqyrave financiare të Bankës për vitin 2018

9. Të ndryshme

Banka Ekonomike Sh.A.

Bordi i Drejtorëve

Ftohen aksionarët e interesuar që, nga dita e publikimit të këtij njoftimi për thirrjen e mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve, në ambientet e zyrës qendrore të bankës, të rishikojnë pasqyrën financiare, me raportet e auditorëve të jashtëm, të bordit të drejtorëve si dhe dokumentet tjera lidhur me propozimin e vendimeve të vendosura në rendin e ditës të mbledhjes së përgjithshme të aksionarëve.

BANKA EKONOMIKE
Sheshi Nënë Tereza, p.nr.
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 500 500
Fax: +383 38 500 507
info@bekonomike.com
www.bekonomike.com

Zyra Qendrore



Njoftim për ndryshim të çmimorës së shërbimeve për klientët fizik dhe juridik

Banka Ekonomike njofton të gjithë klientët e saj se duke filluar nga data 15 Maj 2018, çmimorja për disa shërbime do të pësojë ndryshime.

Shërbimet/çmimet të cilat do të ndryshohen nga data 15 Maj janë:

- Tërheqja e parave të gatshme në arka
- Transferet e brendshme brenda Bankës Ekonomike
- Ndryshimi i normës së interesit për depozita me maturitet 48 muaj
- Produktet kreditore për persona fizik
- Produktet kreditore për persona juridik
- Kamatëvonesa

Për më shumë informata rreth publikimit të çmimores, ju lutemi vizitoni web faqen zyrtare të bankës www.bekonomike.com, apo degën tonë më të afërt për ju, ose kontaktoni Qendrën e Thirrjeve në numrat e telefonit 038 500 500 dhe 049 733 322.

Banka Ekonomike
Mendon për ty!

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nënë Tereza p.nr
10000 Prishtinë, Kosovë

info@bekonomike.com
Tel. +383 (0) 38 500 500
Fax. +383 (0) 38 500 507



Një vepër studimore që e nderon shkencën e albanologjisë - (Vebi Bexheti, "Magjia e fjalës poetike", Tetovë, 2018)

Rilindja kombëtare dhe Rexhep Voka



Prof. dr. Emin KABASHI

Drini në poezinë e Martin Camajt, është i pranishëm, si figurë stilistike, por edhe si mit, edhe kur i këndon shotë Galicës, edhe kur i këndon mjellmës dhe nuses.

Me temën e Drinit të Zi dhe të Drinit të Bardhë në poezinë shqipe, autori ka analizuar edhe poezinë e Ali Podrimës. Është i veçantë shqyrtimi që i bën poezisë Atdheu i mbërthyer në arkë, që ia kushton Martin Camajt. Përveç të tjerësh, vargjet përmblylëse, dëshmojnë për një kuptim të veçantë të dhembjes së copëtimit të atdheut: "vë veshin pastaj dhe dëgjon trokun/mes Drinit të Bardhë e të Zi/që vetëm ti e kupton".

Autori i veprës studimore, Magjia e fjalës poetike, Vebi Bexheti, ka shqyrtuar edhe poezi të krijuesve të tjerë, në poezinë e të cilëve figura e Drinit të Bardhë dhe e Drinit të Zi është e pranishme, jo vetëm si shprehje poetike, por herë si figurë e mendimit, herë tjetër si figurë stilistike, herë më të shpeshta, si figurë mitike.

Ndër poetët që kanë pasur motiv Lumin Drin, janë edhe Xhevahir Spahiu, Agim Vinca, Koçi Petriti, Enver Gjerqeku, Fatos Arapi, e krijues të tjerë. Kurse që në vitin 1909, Josif Bageri, i mëson shqiptarët që ta marrin mësim bashkimin e Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë, që të jenë bashkë për të qenë të lirë.

Praninë së Lumit Drin, autori i këtij studimi, e ka shqyrtuar edhe në poezinë popullore, si një vlerë që i ka përballuar kohës dhe shijeve të lexuesve.

Një studim me interes të veçantë, në këtë vepër studimore, është ai që i kushtohet një rilindësi pak të njohur në të gjitha

hapësirat shqiptare, si dhe në të gjitha nivelet e dijes sonë intelektuale shqiptare. E tillë është, edhe sipas autorit, figura e rilindësit Rexhep Voka.

Duke e vënë në qarkun e krijesve rilindës, jo vetëm për moshën dhe kohën kur ka jetuar dhe ka krijuar, studiuesi Vebi Bexheti, e dëshmon me fakte vlerën kombëtare të veprës dhe dijes së Rexhep Vokës, pa marrë parasysh se në cilën gjuhë i ka shkruar, dhe me cilin alfabet ka shkruar.

Ai, Rexhep Voka, si pjesa më e madhe e rilindësve tanë, ishte mësues i popullit, ishte predikues i fesë, duke e përkufizuar qartë, se pa atdhe, nuk ka as fe, ishte edukator dhe filozof. Pra, ishte krijues, vepra e të cilit i takon frymës së Rilindjes sonë Kombëtar. Këtë aspekt të jetës dhe të veprës së Rexhep Vokës, studiuesi Vebi Bexheti e ka zbuluar bindshëm në studimin e tij.

Çamëria e poezisë shqipe dhe Çamëria e realitetit historik

Çamëria është një plagë kombëtare që kullon gjak edhe sot. Ky është përkufizimi i parë që bën autori i këtij studimi. Çamëria, si pjesë e gjeografisë kombëtare, në poezinë shqipe, të aq shumë krijuesve shqiptarë, ka ardhur edhe si dhembje e pashërueshme, ka ardhur edhe si motiv biblik e mitik, ka ardhur edhe si dashuri e porealizuar, por ka ardhur edhe si shpresë për një të ardhme më të mirë.

Shqyrtimin analizues të pranisë së Çamërisë në poezinë shqipe, studiuesi e fillon me veprën madhore të Naim Frashërit, Bagëti e bujqësia, në të cilën, duke prekur tërësinë e gjeografisë së asaj kohe, të cilën Konferenca e Ambasadorëve në Londër, më 1913, e përgjysmoi, studiuesi ka sjellë në vëmendjen e lexuesit, emërtimet e qyteteve shqiptare që ka zënë në gojë poeti ynë kombëtar, Naim Frashëri: A mos vjen nga Shqipëria? Apo vjen prej Çamërije? Ndërsa qytetet, ku janë edhe qytetet e Çamërisë, i

radhit: "Kostur, Përlep, Follorinë, Dibrë, Ipek e Jakovën /Mat' e Ysqyp e Preshtinë, dhe Mërdit' e Tetovën"/.

Pas tragjedisë të tërësisë së gjeografisë shqiptare, poeti i madh shqiptar, Gjergj Fishta, edhe me poezinë e tij, ka ngritur zërin kundër kësaj padrejtësie historike që bënin Fuqitë e Mëdha të Evropës, duke e ftuar popullin, pra shqiptarët që të marrin armët dhe të mbrojnë tokat e tyre. Në poezinë që ka shqyrtuar studiuesi Vebi Bexheti, Fishta përmend emrat e pjesëve të atdheut, emrat e qyteteve të tokave shqiptare, që u janë dhënë fqinjëve tanë, sidomos në poezinë me titull "Çohi të vdekur".

Në vitin 1941, Asdreni ynë kishte shkruar një poezi me titull "Shqipëria e madhe", që nuk përkonte me ideologjinë e kohës, sidomos pas iluzioneve që kishin krijuar të caktuar, se pas pushtimit italian, ishte momenti i duhur i bashkimit të trojeve shqiptare. Por, si për çudi ky ideal i bashkimit kombëtar, që e hasim te aq shumë poetë shqiptarë, nuk përkonte as me ideologjinë e Shqipërisë mbretërore, as të Shqipërisë komuniste. Në anën tjetër, vargjet lapidare të këtij ideali atdhetar, që lidhet me temën për praninë e Çamërisë në poezinë e disa krijuesve shqiptar, të Prof. Vebi Bexhetit, nuk e kanë mundur asnjë ideologji, pa marrë parasysh sa fjalë boshe kishin thënë në jetën e tyre pushtetare. Andaj, poeti Adren shkruan:

"Mi ball të Shqipërisë, Mëmës së adhuruar /Si hyj po ndrini, Ju, Kosovë e Çamëri" (fq. 104).

Poezi kushtuar Çamërisë, robërisë së saj, dhembjes dhe mallit për të, herë duke ftuar shqiptarët që të bashkohen për çlirimin e krahinave që ju kishin marrë të tjerët, herë duke vajtur gjendjen e mjerueshme nga pushtimi të atyre viseve, herë tjetër, duke dhënë porosinë e madhe se pa luftë nuk ka liri, kanë shkruar shumë poetë, të cilët i ka shqyrtuar në veprën e tij Vebi Bexheti. Ndër ta, përmenden edhe Sejfulla Malëshova, ku në poezinë me

titull Për Kosovë e Çamëri, e cila për shkak të 'mëkatit' të autorit nuk ishte botuar deri në vitin 1998. Sipas studiuesit të kësaj poezie, autori, sejfulla Malëshova, e njihje mirë hartën e gjeografisë shqiptare, andaj thirrja që u bën shqiptarëve, se pa ndihmën e shtetit amë, vështirë se vjen liria për Kosovën dhe Çamërinë. Dhe thotë: "Vëllezër po thërret Kosova e gjorë

/dhe me ngashërime Çamëria e ngratë . Çohuni burra e lidhni dorë për dorë. Mjaftë mbretëroi kjo e zeza natë" (fq. 105-106).

Ndër poetët të që kanë trajtuar në krijimet e tyre, Çamërinë dhe ngjarjet e jetës së saj historike, më së miri e kanë përjetësuar në art, ndoshta vetë krijuesit çamë. Ndër ta, sipas studiuesit Vebi Bexheti, një zë krejt specifik dhe i veçantë, është Bilall Xhaferri, sidomos me poezinë "Baladë çame". Secili peizazh, secila pamje, secila tragjedi e njerëzve çamë, janë dhënë përmes ndjeshmërisë lirike, ndër më të fuqishmet në gjithë lirikën shqiptare me këtë temë. Krijime të tjera të poetëve që i kanë kënduar Çamërisë dhe fatit të saj historik, Çamërisë si realitet artistik dhe Çamërisë si tragjedi kombëtare historike, autori i këtij studimi, ka analizuar edhe poezitë e Ali Podrimës. Një krijues shumë i veçantë, i përkushtuar tërësisht, edhe me artin e tij, në prozë dhe në poezi, është pa dyshim krijuesi Arben Kondi. Vepra e tij, me titull "Kosovë Çamëri", krejt ndryshe nga sa jemi mësuar ta lexojmë në poezinë shqipe, këtu shtrihet në tetë vëllime të veçanta, gjë që dëshmon jo vetëm për preokupimin jetësor krijues të autorit, por dëshmon edhe plagën e madhe kombëtare që është e pranishme në jetën tonë.

Epojeja e Vlorës në krijimet poetike

Vlora është sinonimi i epopesë së pavarësisë shqiptare, ashtu siç e kishte shpallur plaku i urtë, për të katër Vilajetet. Kjo epope e historisë sonë të re, ka gjetur

paraqitje edhe në poezinë e njërit nga krijuesit shumë interesant, jo vetëm për fjalorin poetik, por edhe për lirinë e të thënies poetike.

Krijuesi Ali Asllani, në një cikël të tërë "Rreth epopesë së Vlorës", i ka dhënë zë me fuqinë e artit të poezisë së tij aktit të shpalljes së pavarësisë, e ka përjetësuar në vargjet poetike, babanë e kësaj pavarësie, Ismail Qemalin, ka vënë në peshoren e fjalës poetike përmasën kombëtare të Flamurit kombëtar, por që të gjitha këto, thënë me gjuhën poetike të Ali Asllanit, me fjalorin poetik të tij, krejt specifik, thajse në gjithë poezinë shqiptare, sidomos në atë të Rilindjes dhe të viteve '30-të, ku thjeshtësia e shprehjes poetik, i jep freskinë dhe natyrshmërinë e ligërimit të tij poetik.

Në ciklin "Rreth epopesë së Vlorës", që ka brenda katër poezi, secila duke shpaluar idealin e atdheut dhe gjëmën që po i përgatitej nëpër konferencat ndërkombëtare, por poeti ka shpresë, sepse atë e kanë mbjellë luftëtarët e lirisë. Ali Asllani, si edhe Gjergj Fishta në "Lahutën e Malësisë", që merret edhe me Parisi, edhe me Londrën, merret edhe ky me Parisin, me konferencën që mbahet në atë qytet, edhe pse ai ka besim se askush, e as Parisi, nuk mundet: "të bëjë ç'të dojë, si me kartë edhe me gojë", edhe për faktin se shqiptarët do ta mbrojnë tokën e tyre, lirinë e tyre, edhe me gjak, por edhe për faktin se ai copëtim, nuk është i natyrshëm, sepse, thotë poeti: "s'dahet djali nga e ëma, /s'ndahet koka nga kufoma, /s'shitet Vlora me fermane, s'vishet burri me tumane" (V. Bexheti, 116). Kurse në poezinë që i kushtohet varrimit të Ismail Qemalit, janë karakteristike vargjet, që përmbledhin, jo vetëm prapaskenat e ngjarjeve që janë zhvilluar lidhur me varrimin e tij, por edhe gatishmërinë e vlonjatëve, që ta përcjellin burrin e madh të atdheut ashtu siç e kishte merituar, si babai i atij atdheu, andaj: "Vlora bëri si e deshi, me bajrak të saj e veshi, /Veshi plakun me bajrak, /Me bajrakun ngjyrë gjak" / (Po aty, 117). (Vijon)

MKRS-ja ia ndan 10 mijë euro Fondacionit "Ibrahim Kodra"

Prishtinë, 13 prill (ER) - Në kabinetin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, është nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi me "Ibrahim Kodra-Swiss Foundation".

Qëllimi i këtij memorandum është mbështetja financiare për aktivitetet e arkitektëve të rinj nga Kosova me rastin e pjesë-

marrjes në ngjarjen kolaterale "New Urbanistic" në Bienalen e Arkitekturës së Venedikut për vitin 2018, për promovimin dhe përkrahjen kulturore, gjatë vitit 2018.

Sipas këtij memorandum, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për "Ibrahim Kodra Swiss Foundation" ndan mjetet financiare në vlerë prej 10 mijë

euro.

Kryetarja e këtij fondacioni, Maria Pacolli, ka falënderuar Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për mbështetjen e dhënë duke theksuar se kjo mbështetje financiare ka rëndësi të veçantë për arkitektët e rinj të cilët do të jenë një përfaqësim i denjë në Bienalen e Arkitekturës së Venedikut për vitin 2018.



E rrallë

Piktura e vjedhur e Chagallit gjendet pas 30 vjetësh

Një pikturë e Mark Chagallit e grabitur nga një shtëpi në Nju Jork në vitin 1988 do t'i kthehet familjes pas gati 30 vjetësh. Piktura e vitit 1911 "Otello dhe Dezdemonja" u mor nga apartamenti i Ernest dhe Rose Hellerit, bashkë me një duzinë veprash të tjera arti dhe bizhuterish.



FOTO E DITES



Perëndimi i diellit në qytetin e Pejës. Foto: Granit Dinaj.

E jashtëzakonshme

Minjtë hëngrën 500 kilogramë hashash

Tetë policë janë shkarkuar në Argjentinë për zhdukjen e 500 kilogramëve hashash nga magazinat e sekuestrimit të policisë. Komisionari i inspektimit doli para gjyqtarit bashkë me shtatë policët e tjerë duke bërë me dije se hashashin e zhdukur e kishin hëngër minjtë. Ekspertët që u angazhuan në këtë çështje kanë dyshuar për aftësinë e minjve për të ngrënë një sasi kaq të madhe hashashi.



BARSOLETA E DITËS



- A e di se 'iPhone' i ri ka aplikacion për dobësim?
- E si funksionon?
- E blen, pastaj nuk ke para për bukë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:30

"BLACK PANTHER"

3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

"PETER RABBIT"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.

Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

"PACIFIC RIM UPRISING" (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

"RED SPARROW" (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Schoenarts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.
Regjia: Francis Lawrence



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Sot ju është besuar një detyrë e rëndësishme që duhet ta përmbyllni me sukses. Dikush ka besim të palëkundur tek ju.



DEMI

Duhet të jeni objektiv kur

vlërësoni personat afër jush dhe të mos ndikoheni nga të tjerët. Dëgjoni më shumë seç duhet fjalët e të tjerëve.



BINJAKËT

Sot mund ta shijoni ditën pa e pasur

mendjen tek ngarkesat në punën tuaj ose në familje. Çdo gjë do të rregullohet siç keni ëndërruar.



GAFORRJA

Do ta keni durimin të merreni

edhe me tipa të vështirë sot. Me harmoninë dhe entuziazmin që ju karakterizon do të bëni për vete këdo.



LUANI

Sot është një ditë jo si gjithë të

tjerat dhe lajmi që keni marrë do ta bëjë akoma më interesant. Ju pëlqen të eksperimentoni me gjërat e reja.



VIJGJËRESHA

Keni mësuar ta ruani qetësinë

dhe të mos reagoni me impulsivitet. Jeni të durueshëm të dëgjoni të tjerët deri në fund për gjërat që ju thonë.



PESHORJA

Keni harxhuar kohë duke u marrë me

gjëra që janë jashtë interesit tuaj. Jeni të ndërgjegjësuar dhe nuk do të pranoni asnjë devijim nga planet tuaja.



AKREPI

Po kaloni në një terren që edhe në të

shkuarën ju ka shkaktuar neveri, por të kondicionuar nga situata të caktuara, sot nuk keni si të veproni.



SHIGJETARI

Sot do të keni më shumë besim në

vete dhe tani do të kuptoni se gjërat për të cilat keni luftuar prej kaq kohësh do t'ju shpagojnë mundin.



BRICJAPI

Po lejoni që persona të caktuar

t'ju kritikojnë pa asnjë arsye. Sot do të ndiheni të plotgësit.



UJORI

Sot do të realizoni shumë mirë një

projekt që ju është caktuar. Nëse e shtyni për më vonë, do të keni mjaft pengesa dhe probleme.



PESHQIT

Nuk do të jetë një ditë aspak e

thjeshtë kjo e sotmja. Do të keni mjaft debate në punë dhe kundërshti mendimesh me kolegët.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BURNLEY - LEICESTER

GG3+

SOUTHAMPTON - CHELSEA

3+

TOTTENHAM - MAN CITY

2

KOK-u, memorandume me Komunën e Gjilanit dhe të Dardanës

PRISHTINË, 13 PRILL (ER) - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Komunën e Gjilanit, e cila bëhet bashkëfinancuese me KOK-un për bursisten olimpike, karateisten Fortesa Orana. Memorandumi u nënshkrua nga presidenti i KOK-ut, Besim Hasani dhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri.

Karateistja Orana është bursiste për Lojërat Olimpike "Tokyo 2020". KOK-u, falë projektit të fituar në Solidaritetin Olimpik të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, i jep nga 150 dollarë në muaj Oranës, kurse nga buxheti i vet i ndanë nga 100 euro të tjera në muaj. Komuna e Gjilanit obligohet të paguajë nga 100 euro Fortesa Oranës deri në përfundim të ciklit olimpik 2020. Pjesë e takimit ishin edhe sekretari i përgjithshëm i KOK-ut,

Shasivar Haxhijaj dhe udhëheqësi për Sport në Komunën e Gjilanit, Malazog Hoxha.

Drejtuësit e KOK-ut e informuan kryetarin Haziri dhe udhëheqësin për sport, Hoxha, edhe për përfitimet që sjell Ligji për Sponsorizim, nga të cilët kërkuan t'i nxisin bizneset e Komunës së Gjilanit të investojnë në sport. Po ashtu, u bisedua edhe për organizimin e Panairit të Sportit 2018, që mbahet në shtator në kuadër të Javës Evropiane të Sportit, si dhe organizimin e Ditës Olimpikë në Gjilan që mbahet më 25 maj 2018.

Kryetari Haziri, duke falënderuar drejtuesit e KOK-ut për iniciativën e marrë me rastin e sqarimit të Rregullores për Ligjin për Sponsorizim ku, krahas krerëve të Komunës, Rregullorja iu sqarua edhe bizneseve dhe klubeve, shprehu gatishmërinë për ta ndihmuar sportin gjilanas, në veçanti klubeve.



Pas Komunës së Gjilanit, Komiteti Olimpik i Kosovës ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi edhe me Komunën e Dardanës, e cila bëhet bashkëfinancuese me KOK-un për tre bursistët olimpike, të cilët vijnë nga kjo komunë: Musa Hajdari, Vjona Kryeziu dhe Astrit Kryeziu. Memorandumi u nënshkrua

nga presidenti i KOK-ut, Besim Hasani dhe kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati. Të tre atletët e klubit Rogana nga Dardana do të përfitojnë nga komuna e tyre nga 100 euro në muaj, e cila kontratë vlen deri në ciklin olimpik "Tokyo 2020". Krahas kësaj, KOK-u, falë projektit të fituar në Solidaritetin Olimpik të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, që nga shtatori

i vitit të kaluar u jep nga 150 dollarë në muaj këtyre sportistëve, kurse nga buxheti i vet i ndanë edhe nga 100 euro të tjera në muaj. "Presidenti Hasani e njoftoi kryetarin Kastrati se komuna që ai drejton është e treta pas Prishtinës dhe Pejës për nga numri i sportistëve të përzgjedhur nga Bordi Ekzekutiv i KOK-ut, si sportistë potencialë për ta fituar normën olimpike 'Tokyo 2020'. Po ashtu, drejtuesit e KOK-ut e informuan kryetarin Kastrati edhe me përfitimet që sjell Ligji për Sponsorizim, nga të cilët kërkuan t'i nxisin bizneset e Komunës së Dardanës të investojnë në sport. Palët biseduan edhe për organizimin e Panairit të Sportit 2018 që mbahet në shtator në kuadër të Javës Evropiane të Sportit, si dhe organizimin e Ditës Olimpikë në Dardanë, që mbahet më 25 maj 2018", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

LK: Bayern - Real dhe Liverpool - Roma

NYON, 13 PRILL - Bayern - Real dhe Liverpool - Roma janë çiftet gjysmëfinaliste që përcaktuan goglat e shortit të hedhur në Nyon të Zvicrës, nën përzgjedhjen e ambasadorit të Ligës së Kampionëve të sivjetshëm, Andriy Shevchenko. Sikurse në Evropa Ligë, edhe në kompeticionin më prestigjioz të Evropës për klube, shorti i kësaj faze nuk kishte kufizime, e përballjet ishin të hapura për cilindo mes katër pretendenteve të mbetur në garë, gjermanët e Bayernit, italianët e Romës, anglezët e Liverpoolit, si dhe spanjollët kampionë në fuqi të Evropës, Real Madrid. Ndeshjet e para do të luhën të martën e 24 prillit dhe të



mërkurën e 25 prillit, ndërsa ato të kthimit më 1 dhe 2 maj. Rrugëtimi drejt finales së Kievit, edhe në Ligën e Kampionëve ka mbërritur në

distancën më të shkurtër, aty ku nuk lejohet asnjë gabim për ata që duan t'i rrëzojnë nga fronti madrilenët e Realit, apo edhe për këta të fundit nëse

duan ta fitojnë titullin e tretë radhazi, raporton "TopChannel". Finalja e madhe, mes fituesit të çiftit të parë dhe fituesit të çiftit të dytë, do të luhet të shtunën e 26 majit në stadiumin "NSC Olimpiyskiy" të Kievit në Ukrainë, ku kryebashkiak është një emër i njohur botëror, ish-boksieri Vitaly Klitschko.

EL: Marseille - Salzburg dhe Arsenal - Atletico

Marseille - Salzburg dhe Arsenal - Atletico janë dy çiftet e gjysmëfinaleve që do të diskutojnë mes tyre se cilët do të jenë finalistët e Lionit, në ndeshjen që do ta përcaktojë

edhe fituesin Evropa Ligës të mërkurën e 16 majit. Katër ishin pretendentët e mbetur, pas ndeshjeve çerekfinale të luajtura të enjten në mbrëmje, ndërsa shorti nuk pati asnjë kufizim për përballjet e mundshme. Shorti është hedhur përmes ndihmës së ambasadorit të finales së këtij viti, të kompeticionit të dytë për nga rëndësia në kontinentin e vjetër, Eric Abidal. Gjysmëfinalët do të zhvillohen të enjten e 26 prillit dhe të enjten e 3 majit, datë pas së cilës do të mësohen dy ekipet finaliste. Fituesi i çiftit Marseille - Salzburg do ta presë fituesin e çiftit Arsenal - Atletico në finalen e Lionit.

Gjilani - Feronikeli ndahen në paqe

GJILAN, 13 PRILL - Është zhvilluar ndeshja hapëse e javës së 27 në Vala Superligën e Kosovës ndërmjet Gjilanit dhe Feronikelit, e cila është mbyllur pa fitues dhe pa gola. Feronikeli pati më shumë nga loja, por nuk arriti ta gjejë golin. Kësisoj, skuadra nga Drenasi regjistroi barazimin e tretë me

radhë nën drejtimin e Sulejman Starovës, derisa Gjilani merr një pikë të rëndësishme për të qëndruar larg zonës së barazhit. Ndërsa derbi i kësaj xhiroje zhvillohet të shtunën në mes të skuadrës së Lirisë dhe Llapit. Të dielën liderja e elitës, Drita, e pret skuadrën e Vllaznisë së Pozharanit.



VALA SUPERLIGA

Gjilan-Feronikel 0-0

Të shtunën takohen:
Liria-Llapi
Prishtina-Besa
Drenica-Flamurtari

Të dielën takohen:
Trepça '89-Vëllaznimi
Drita-Vllaznia e Pozharanit

Kovaq, trajner i Bayernit

MUNCHEN, 13 PRILL - Niko Kovaq është zyrtarizuar trajner i ri i Bayern Munchenit. Drejtori sportiv i klubit "bavarez", Hasan Salihamidziq, ka njoftuar se Kovaqi do ta nisë punën më 1 korrik. Ish-futbollisti kroat, i cili është trajneri aktual

i Eintracht Frankfurtit, do ta zëvendësojë në stolin e Bayernit veteranin Jupp Heynckes dhe do të nënshkruajë një kontratë trevjeçare. Niko Kovaq ka qenë lojtar i skuadrës më të madhe gjermane në periudhën 2001-2003. Edhe pse

e nisi punën me një skuadër në zonën e rënies nga kategoria, Kovaqi sezonin e fundit e mbylli në vendin e 11. Aktualisht, Frankfurti është në vendin e pestë në kampionat, vetëm dy pikë larg zonës së Ligës së Kampionëve.



Bashkimi i motivuar në prag të 'Final Four'-it

PRISHTINË, 13 PRILL - KB Bashkimi është në prag të ndeshjes së parë të "Final Four"-it historik në SIGAL-UNIQA Ligën Ballkanike. Skuadra e Prizrenit është e uritur ta provojë veten dhe të performojë në nivelin më të lartë të mundshëm. Dhe për këtë kanë folur për faqen zyrtare të Ligës Ballkanike, kryetari i KB Bashkimi, Shaqir Totaj dhe kapiteni Qendrim Biraj. "Kjo është mundësia jonë e artë për të dëshmuar edhe një herë se sa i madh është pasioni për sport, kur e ke një qëllim, për t'u përqendruar në atë qëllim dhe për të mos u dorëzuar asnjëherë për 'play-off' deri në fund. Fituesi nuk është ai që nuk humbet kurrë, por ai që nuk heq kurrë dorë. Pavarësisht nga edicioni shumë i vështirë financiar, ne nuk kemi hequr kurrë dorë. Kjo është mundësia jonë për ta përfaqësuar qytetin tonë dhe vendin tonë në mënyrën më të mirë të mundshme. Rezultatet e mira janë gjithmonë të rëndësishme, por qëllimi ynë primar do të jetë loja korrekte, respektimi i rregullave dhe të gjithë pjesëmarrësve, dhe ta promovojmë qytetin tonë dhe vendin tonë. Duke qenë pjesë e BIBL F4 kemi arritur shumë më shumë sesa që ne ndoshta prisnim, por ne nuk po e konsiderojmë veten inferiorë asnjëherë. Pas kualifikimit të këtij



viti për BIBL F4 do të na shikojnë më seriozisht të gjithë partnerët tanë dhe kjo do të na ndihmojë ta rrisim profilin e klubit dhe ekipit menaxhues dhe shpeshojmë se do të na ndihmojnë të qëndrojmë më mirë financiarisht për edicionin e ardhshëm dhe, pse jo, ndoshta këtë vit të bëhemi kampion i Kosovës", ka thënë Shaqir Totaj, kryetar i KB Bashkimi. Ndërsa kapiteni Qendrim Biraj ka deklaruar se: "Fakti që ne kemi siguruar vend në Final Four për herë të parë pas tre vjetësh si një ekip, na bën të ndihemi mirë dhe të motivuar për sfidat e ardhshme. Tani në 'Final Four' ne e dimë se do të përballemi me skuadra me cilësi të lartë, por ne do të japim më të

mirën nga vetja për të marrë disa rezultate pozitive. Në këto ndeshje, gjëja më e rëndësishme është që të gjithë lojtarët duhet ta mbështesin njëri-tjetrin, të luftojmë dhe të besojmë deri në fund për rezultate të mira". Të shtunën në kuadër të Final Four të BIBL-it do të takohen në gjysmë-finalen e parë, Blokotechna (Gjergjeli) dhe Levski Lukoil (Sofje) në orën 15:00. Në të njëjtën ditë do të luhet edhe gjysmëfinalja e dytë ndërmjet Rilski Sportist (Samokov) dhe Bashkimit nga Prizreni (Kosovë). Ky takim do të zhvillohet duke filluar nga ora 18:30. Ndërkaq të dielën do të luhet finalja e madhe e BIBL-it, si dhe ndeshja për vend të tretë.

Shqipëria, miqësore me Uellsin në nëntor

TRANË, 13 PRILL - Kombëtarja e Shqipërisë do të luajë miqësore me Uellsin më 20 nëntor, në "Elbasan Arena". Të dyja federatat përkatëse janë pajtuar dhe kanë zyrtarizuar zhvillimin e këtij takimi në këtë datë. Kujtojmë se në periudhën shtator-dhjetor të këtij viti skuadra përfaqësuese e Shqipërisë do t'i zhvillojë takimet zyrtare eliminatore për grupin e saj në kompeticionin e Ligës së Kombeve (UEFA Nations League), por duke qenë se grupi është me tri skuadra ajo do t'i zhvillojë në datat përkatëse edhe dy ndeshje miqësore, një prej të cilave është kjo me Uellsin, raporton "SS". Mund të konsiderohet një provë e vërtetë zjarri për kuqezinjët, duke qenë se bëhet fjalë për një skuadër që në "Euro 2016" surprizoi mbarë botën, duke shkuar deri në gjysmë-finalen e kompeticionit kontinental, ku u eliminua nga Portugalia, që më pas do të shpallej kampione e



Evropës. Uellsin renditet në vendin e 21-të në klasifikimin e FIFA-s, aty ku në vitet e fundit ka arritur të futet edhe në dhjetëshen e parë. "Ylli" i padiskutueshëm i skuadrës, njëkohësisht golashënuesi më i mirë në historinë e saj është Gareth Bale, ndërkohë që në stol drejtohet nga legjenda e Manchester Unitedit,

Ryan Giggs. Shumica e futbollistëve luajnë në Premierë Ligë ose ligat e tjera të futbollit anglez dhe për nga vetë karakteristikat për Shqipërinë është kundërshtari ideal për t'i matur forcat si një skuadër mjaft e ngjashme me Skocinë, rivalen e kuqezinjve në grupin e Nations League.

SHKURT

Thyhet rekordi i shikueshmërisë në NBA

Për të katërtin vit me radhë, NBA ka vendosur një rekord të ri për sa i përket shikueshmërisë së tifozëve në ndeshjet e sezonit të rregullt. Në përfundim të javës së 82-të të sezonit të rregullt është konfirmuar se numri në total i shikuesve ka qenë 22,1 milionë njerëz, që kanë ndjekur "live" ndeshjet në shkallët e stadiumeve të 30 skuadrave. Kjo është hera e parë që NBA arrin kuotën e 22 milionë shikuesve në sezonin e rregullt. Një vit më parë kjo shifër ishte 21.9 milionë shikues, ndërkohë që në katër sezonet e fundit shikuesit janë shtuar. Mesatarja e shikuesve për ndeshje ka qenë 17 987 tifozë, 100 më shumë krahasuar me 17 884 shikues për ndeshje e vitit të kaluar.

Mane, lojtar i vitit në Ligën e Kampionëve

Anësori i Liverpoolit, Sadio Mane, është shpërblyer pas super paraqitjes kundër Manchester Cityt në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Ai është emëruar lojtari i javës, duke mposhtur Edin Dzekon, Mario Mandzukiqin dhe Arjen Robbenin.

Skënderbeu rikthen titullin kampion në CAS

Skënderbeu i është rikthyer titulli kampion i sezonit 2015-2016, i hequr nga Komisioni i Disiplinës i futbollit shqiptar. Klubi korçar ka njoftuar përmes faqes së vet zyrtare në rrjetet sociale, se Gjykata e Arbitrazhit Sportiv, CAS, ka pranuar kërkesën e dorëzuar nga Skënderbeu në gusht të vitit të kaluar.

Klopp: Roma ka një ekip shumë të mirë

Liverpooli ka gjetur surprizën e këtij sezoni në Ligën e Kampionëve, Romën, dhe trajneri Jurgen Klopp e ka bërë të qartë se asnjë nuk duhet ta marrë si një short të lehtë. Ai parashikon një ndeshje të vështirë dhe kujton edhe performacën që kryeqytetasit zhvilluan me Barcelonën. "Nuk është short i lehtë. Njësoj do të ishte edhe me Bayernin dhe Realin. Të gjitha ekipet në këtë fazë janë të forta. Dua t'ju kujtoj ndeshjen që Roma zhvilloi me Barcelonën. Unë nuk kam qenë kurrë në Romë, por di që ka një skuadër shumë cilësore. Ne do të tentojmë të marrim rezultate pozitive në të dyja ndeshjet", ka thënë trajneri i Liverpoolit. Ndeshja në mes të Liverpool dhe Romës do të luhet më 24 prill në Angli.

Premierë Liga refuzon VAR-in

Autoritetet e Ligës Premierë kanë konfirmuar se nuk do të ketë implementim të plotë të Video Assistant Referee, apo teknologjisë së njohur ndryshe si VAR. VAR-i ishte implementuar në disa kampionate, ku ka pasur ndikim me ndryshimin e shumë rezultateve. Kërkesa për VAR ishin të mëdha në mesin e tifozëve në Ligën Premierë, kërkesa të cilave iu bashkuan edhe klube të ndryshme. Megjithatë, me t'u hapur kjo çështje në një mbledhje të Ligës Premierë, klubet e këtij kampionati kanë vendosur kundër implementimit të plotë të këtij sistemi për sezonin e ardhshëm. Liga Premierë ka konfirmuar se VAR do të përdoret në FA Cup dhe Carabao Cup për sezonin e ardhshëm. "Kërkojmë përmirësime të mëtutjeshme në sistem, sidomos për komunikimin në stadium dhe për ata që ndjekin ndeshjet në shtëpi apo përreth botës", thuhet në një komunikatë të Ligës Premierë.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada-Government
 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
 Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
 Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

ZYRA PËR KOMUNIKIM ME PUBLIKUN/ KANCELARIJA ZA JAVNO
 KOMUNICIRANJE/
 OFFICE OF PUBLIC COMMUNICATION

THIRRJE PËR APLIKIM

PROGRAM I VEÇANTË PËR INVESTIMET NË INFRASTRUKTURËN RURALE DHE NGRITJA E AFTËSISË KONKURRUESE NË SEKTORIN E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË PËRMES PËRFSHIRJES SË KOMUNITETIT NË ZHVILLIMIN RURAL NË REGJIONIN E MITROVICES SË VERIUT

1. PROGRAM I VEÇANTË PËR INVESTIMET NË INFRASTRUKTURËN RURALE

Data e shpalljes: 14 Prill 2018

Data e mbylljes: 15 Maj 2018

Kërkesat për aplikim për investimet në infrastrukturën rurale mund të sillen direkt në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në arkivin qendror të MBPZHR-së, zyra nr. 242 ose me emal në: Arkiva.MBPZHR@rks-gov.nct.

1. ARSYESHMËRIA

Përpunimi i produkteve blegtorale dhe të hortikulturës po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, pasi kërkesa e tregut për sasi të freskëta të disa prej frutave, mishit dhe perimeve po fillon të plotësohet nga prodhimi vendor.

Duke parë zhvillimin e hovshëm në zingjirin e furnizimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore, prodhuesit në Kosovë duhet të përgatiten për një sistem të ndryshëm të shitjes me pakicë, në të cilin duhet kushtuar më shumë vëmendje cilësisë dhe konsistencës. Situata e fermerëve në BE dhe në vendet që eksportojnë në BE tregon se veçanërisht fermerët e vegjël përfitojnë nga bashkimi në kooperativat e bujqve. Niveli i ulët i organizimit / integritetit dhe mjedisi i papërshtatshëm kontraktues janë një sfidë tjetër për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë.

Spektori i bujqësisë në Kosovë përbëhet kryesisht nga fermerët e vegjël që veprojnë me teknologji dhe sisteme joefikase të furnizimit dhe marketingut. Shumica e fermave janë ekonomi familjare, prandaj prodhimi i tyre shërben për nevojat e ekonomisë familjare dhe çdo tepriçë shitet në tregjet rurale ose urbane.

2. SEKTORËT

Investimet në infrastrukturë rurale në kuadër të kësaj mase do të kenë për fokus sektorët: a) pemë, b) perime, c) mish, d) tregje bujqësore, dhe e) fabrikën për përpunimin e mbetjeve organike.

3. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Objektiv i përgjithshëm i kësaj mase janë investimet në infrastrukturën rurale, të cilat do të kenë ndikim të drejtpërdrejt në rritjen e aftësisë konkurruese të sektorëve të mbështetur.

3.1 OBJEKTIVAT E VEÇANTA

3.1.1 Sektori i pemëve

Objektivat e veçanta të kësaj nën mase janë:

- Zbatimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së (higjiena, siguria ushqimore, cilësia, etj.);
- Investimet në objekte për ruajtje dhe deponimin e frutave dhe në teknologji, si dhe modernizimi i objekteve të tjera përcjellëse (depot ruajtëse / ftohëse) duke futur pajisje / teknologji të reja;
- Përmirësimi i marketingut;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

3.1.2 Sektori i perimeve

Objektivat e veçanta të kësaj nën mase janë:

- Zbatimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së (higjiena, siguria ushqimore, cilësia, etj.);

- Investimet në objekte për ruajtje dhe deponimin e frutave të imta dhe perimeve, në teknologji, si dhe modernizimin e objekteve të tjera përcjellëse (depot ruajtëse / ftohëse) duke futur pajisje / teknologji të reja;
- Përmirësimi i marketingut;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

3.1.3 Sektori i përpunimit të mishit

Objektivat e veçanta të kësaj nën mase janë:

- Zbatimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së për prodhimet e mishit (higjiena, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve, ruajtja e mjedisit, etj.);
- Futja e linjave të reja të përpunimit të mishit;
- Futja e prodhimeve të reja ose diversifikimi i prodhimeve në industrinë e mishit;
- Përmirësimi i marketingut të mishit dhe produkteve të mishit;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

3.1.4 Sektori i tregjeve të produkteve bujqësore

Objektivat e veçanta të kësaj nën mase janë:

- Zbatimi i standardeve kombëtare dhe atyre të BE-së (higjiena, siguria ushqimore, cilësia, etj.);
- Investimet në tregun modern për shitje dhe tregtim të produkteve bujqësore, në teknologji, si dhe në modernizimin e objekteve të tjera përcjellëse (depot ruajtëse / ftohëse) duke futur pajisje / teknologji të reja;
- Përmirësimi i marketingut;
- Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve.

3.1.5 Sektori i përpunimit të mbetjeve organike

Objektivat e veçanta të kësaj nën mase janë:

- Eliminimi i mbetjeve organike në proceset e prodhimit dhe përpunimit (p.sh. mbetjet e pularive, përpunimit të pemëve, perimeve, verës dhe birrës), të cilat deri më tani hedhën në natyrë si mbetje dhe ndotin ambientin dhe lumenjtë;
- Prodhimi vendor i plehut vendor organik të cilësisë së lartë;
- Ulja e importit të plehut dhe zëvendësimi i tij me prodhim vendor me burim të lëndës së parë vendore;
- Rritja e cilësisë së plehut në treg me çmim më konkurrues dhe, si pasojë, rritje e cilësisë së prodhimit të pemëve dhe perimeve;
- Krijimi i një burimi shtesë i të hyrave për kompanitë përpunuese (p.sh. fermtat e pulave, përpunuesit etj.);
- Zvogëlimi i kultivimit me plehra konvencionale dhe artificiale.

4. KRITERET E PËRBASHKËTA TË PRANUESHMËRISË

Bizneset bujqësore të regjistruara duhet të kenë burime të qëndrueshme dhe të mjaftueshme financiare për të bashkë financuar projektin sipas kriterëve të parapara. Bashkëfinancimi nënkupton kapital financiar të mjaftueshëm për operacionalizimin e investimit. Nëse një aplikacion dorëzohet nga një grup i kompanive/kooperativave, kërkesat minimale aplikohen për tërë grupin si tërësi, dhe kompanitë /kooperativat kanë të drejtë të përdorin referencat e njëra tjetrës. Në rast se shuma e grantit që kërkohet nga Ministria është 1,000,000.00 Euro, atëherë aplikuesi duhet të ofrojë dëshmi se qarkullimi financiar në tri (3) vitet e fundit është të paktën 3 milionë Euro. Ky proporcioni i qarkullimit bankar financiar vlen për të gjitha shumatat e kërkuara për të cilat aplikuesit aplikojnë.

5. QËNDRUESHMËRIA EKONOMIKE E NDËRMARRJES

Aplikuesi duhet të demonstrojë në planin e biznesit qëndrueshmërinë ekonomike të ndërmarrjes në fund të realizimit të projektit. Ndërmarrja duhet të demonstrojë se ajo mund t'i kryejë detyrimet dhe borxhet rregullisht, pa vënë në rrezik funksionimin normal të ndërmarrjes. Në rast të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit duhet ta dorëzojnë edhe projektin teknik të planit të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit.

Qarkullimi financiar në tri vitet e fundit (2015, 2016, 2017) duhet të jetë më i madh ose barazi me dyherësh vlerën e shumës së kërkuar nga Ministria. Në rast se shuma e garantit që kërkohet nga Ministria është 1,000,000.00 Euro, atëherë aplikuesi duhet të ofrojë dëshmi se qarkullimi financiar në tri (3) vitet e fundit është të paktën 3 milionë Euro. Ky proporcioni i qarkullimit bankar financiar vlen për të gjitha shumatat e kërkuara për të cilat aplikuesit aplikojnë.

6.3. KRITERET E TJERA TË PRANUESHMËRISË

Në rastin e projekteve të ndërtimit / rinovimit / zgjerimit, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet t'i dorëzojnë:

- Certifikatën e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës në të cilën do të bëhet investimi;
- Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit;
- Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- Kopjen e skicave të objektit;
- Parallogaritë e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara.

Pëlqimin nga organi kompetent (Komuna) për leje të ndërtimit, në rastet e projekteve të ndërtimit / zgjerimit, por jo në rastet e projekteve të rinovimit.

Ndërsa, para kërkesës për pagesë, duhet ta dorëzojë:

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent (Komuna). Leja nuk kërkohet për projektet e rinovimit;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, nëse është paraparë me ligj;
- Përfituesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore, tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimet e tjera të aplikueshme;
- Përfituesit nuk mund t'i jepet një projekt i ri nëse projektet e mëparshme nuk janë përfunduar në përputhje me kontratën e nënshkruar me MBPZHR/AZHB;
- Projektet e financuara nga ky program nuk bën të jenë të financuara nga Programi i Zhvillimit Rural 2018, nga Zyra e BE-së në Kosovë apo ndonjë donator tjetër publik vendor ose ndërkombëtar. Në rast se përfituesi ka përfituar përkrahje për projektin e njëjtë edhe nga ndonjë donator tjetër, atij nuk i jepet përkrahja ose nëse e ka marrë atë, ai do të detyrohet t'i kthejë mjetet e marra, si dhe ndaj tij do të zbatohen ndëshkimet në përputhje me ligjin;
- Përfituesi, i cili ka aplikuar në MBPZHR / AZHB dhe institucione tjera publike apo në zyrën e BE-së në Kosovë dhe projekti i tij përzgjidhet për financim nga ndonjëri prej institucioneve, duhet menjëherë të informojë MBPZHR / AZHB apo institucionet tjera përkatëse.

Të gjithë përfituesit, të cilët në planin e tyre të biznesit kanë deklaruar se do të krijojnë vende të reja të punës dhe për këtë kanë fituar pikë gjatë vlerësimit, duhet t'i krijojnë ato dhe të dëshmojnë me pagesën e kontributit pensional dhe tatimit në paga duke filluar së paku nga muaji i fundit para kërkesës për pagesën e fundit. Përfituesit janë të obliguar t'i mbajnë këto vende pune të plotësuar me punëtorë me orar të plotë për 5 vjet, aq sa zgjat periudha monitoruese.

6. INVESTIMET E PRANUESHME

- Ndërtimi i objekteve;
- Blerja e makinerive dhe pajisjeve të reja, duke përfshirë programe kompjuterike të nevojshme për funksionimin e linjave të prodhimit apo funksioneve të tjera primare që ndërlihen me aktivitetet kryesore të ndërmarrjes;
- Të pranueshme janë investimet në nën sektorët e ruajtjes së pemëve dhe të perimeve, përpunimit të mishit, si dhe tregtimit të produkteve bujqësore, përfshirë edhe shpenzimet e marketingut për promovimin e tyre, si dhe përpunimit të mbetjeve organike.

Shpenzimet e pranueshme të marketingut për të gjitha nën masat janë: përgatitja dhe shtypja e katalogëve, fletëpalosjeve, broshurave, posterëve, etj., për promovim të produkteve, por jo edhe për shpërndarje të tyre. Po ashtu, shpenzime të pranueshme të marketingut janë edhe prodhimi i audio dhe video-spotëve promovuese, por jo edhe shpërndarja e tyre mediale.

Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për marketing është e kufizuar në 5% të totalit të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 10,000 €.

Shpenzimet e tjera të ndërlihdura me projektin, siç janë: shpenzimet për arkitekt, për inxhinier dhe shpenzimet për studime parapake, si dhe nxjerrja e dokumenteve dhe lejeve relevante janë të pranueshme deri në 7% të shpenzimeve të pranueshme, por jo më shumë se 15,000 €, kurse shpenzimet për përgatitjen e planit të biznesit janë të pranueshme deri në 3% të shpenzimeve të pranueshme për projekt, por jo më shumë se 5,000 €.

Shpenzimet administrative, edhe pse ndodhin para nënshkrimit të kontratës, janë të pranueshme vetëm në qoftë se projekti është përzgjedhur dhe është kontraktuar nga MBPZHR-ja.

7.1. INVESTIMET E PRANUESHME PËR NËNSEKTORË

7.1.1 Investimet e pranueshme për sektorin e pemëve

Investimet e pranueshme për këtë nën masë janë:

- Ndërtimi i një qendre për ruajtjen në temperaturë të ngrirjes së pemëve në komore ftohëse dhe më pas përpunimit të pemëve në lëngje dhe produkte tjera:
 - a. Rregullimi dhe ndërtimi i bazës së objektit;
 - b. Ndërtimi i konstruksionit të jashtëm;
 - c. Ndërtimi /vendosja e kulmit;
 - d. Ndërtimi i konstruksionit të brendshëm;
 - e. Blerja/montimi i dyerve dhe dritareve;
 - f. Instalimi i rrymës dhe ujit e kanalizimit;
- Komore për ngrirjen e shpejtë të pemëve;
- Komore me ftohje të thellë për ruajtjen e pemëve;
- Frigorifer dhe pajisje ftohëse;
- Pajisje për kalibrim;

- Hapësira për selektimin, klasifikimin, paketimin, përpunimin dhe tregtimin e pemëve.

7.1.2 Investimet e pranueshme për sektorin e perimeve

Investimet e pranueshme për këtë nën masë do të jenë:

- Ndërtimi i një qendre për ruajtjen në temperaturë të ngrirjes së pemëve në komore ftohëse dhe më pas përpunimit të pemëve në lëngje dhe produkte tjera:
 - a. Rregullimi dhe ndërtimi i bazës së objektit;
 - b. Ndërtimi i konstruksionit të jashtëm;
 - c. Ndërtimi /vendosja e kulmit;
 - d. Ndërtimi i konstruksionit të brendshëm;
 - e. Blerja/montimi i dyerve dhe dritareve;
 - f. Instalimi i rrymës dhe ujit e kanalizimit;
- Komore për ngrirjen e shpejtë të pemëve;
- Komore me ftohje të thellë për ruajtjen e pemëve;
- Frigorifer dhe pajisje ftohëse;
- Pajisje për kalibrim;
- Hapësira për selektimin, klasifikimin, paketimin, përpunimin dhe tregtimin e pemëve të imta dhe perimeve.

7.1.3 Investimet e pranueshme për sektorin e mishit

- Investimet në ndërtimin e objektit/fabrikës, përfshirë depot ftohëse bashkë me pajisje;
- Investimet në pajisje për përpunim të mishit;
- Investimet në pajisje për përmirësimin e higjienës, si dhe cilësisë dhe sigurisë së prodhimeve (sidomos për të arritur standardet HACCP dhe / ose ISO 22000);
- Investimet në pajisje për përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit, sidomos për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të shkarkuara;
- Investimet për pajisje për kontroll të cilësisë, përfshirë laboratorët përkatës;
- Investimet për pajisje për ftohje dhe ngrirje për ruajtjen e prodhimeve të gatshme;
- Automjete të specializuara për bartjen e lëndës së parë dhe prodhimeve të gatshme;
- Investimet në teknologji për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme;

7.1.4 Investimet e pranueshme për sektorin e tregjeve të produkteve bujqësore

Investimet e pranueshme për këtë nën masë janë:

- Ndërtimi i infrastrukturës fizike të tregut për tregtimin e produkteve bujqësore komore ftohëse:
 - a. Rregullimi dhe ndërtimi i bazës së objektit;
 - b. Ndërtimi i konstruksionit të jashtëm;
 - c. Ndërtimi /vendosja e kulmit;
 - d. Ndërtimi i konstruksionit të brendshëm;
 - e. Instalimi i rrymës dhe ujit e kanalizimit;
- Komore për ngrirjen e shpejtë të pemëve;
- Frigorifer dhe pajisje ftohëse;
- Tavolinat për shitje;
- Hapësira për selektimin, klasifikimin, paketimin, përpunimin dhe tregtimin e pemëve të imta dhe perimeve.

7.1.5 Investimet e pranueshme për qendrën e përpunimit të mbetjeve organike

Investimet e pranueshme për këtë nën masë janë:

1. Ndërtimi (komplet i fabrikës - pjesa e grumbullimit, përpunimit, prodhimit dhe zyret administrative);
2. Infrastruktura përcjellëse për funksionimin e pikës;
3. Pajisjet teknologjike të grumbullimit dhe përpunimit;
4. Pajisjet teknologjike të prodhimit dhe paketimit;
5. Mjetet e transportit të grumbullimit dhe të funksionimit të brendshëm të pikës.

8. SHTRIRJA GJEOGRAFIKE E MASËS

Investimet në kuadër të kësaj mase do të shtrihen në 5 rajonet e Republikës së Kosovës. Bazuar në kushtet klimatike dhe shtrirjes gjeografike rajonet e përzgjedhura për investime në infrastrukturë rurale janë si në vijim: a) investimet në sektorin e perimtarisë do të shtrihen në Rajonin e Prizrenit, b) investimet në pemëtari rajoni i Mitrovicës, me theks të veçantë pjesa veriore, c) sektori i mishit prodhimi primar dhe përpunim në rajonin e Pejës, d) ndërtimi i tregut modern për produkte bujqësore në Prishtinë dhe e) ndërtimi i qendrës për përpunimin e mbetjeve organike dhe prodhimin e plehut organik në Gjilan.

9. SHKALLA E PËRKRAHJES PUBLIKE

Shkalla e mbështetjes publike është 50 % të vlerës së investimit.

Agrobizneset do të futen në listën e ngushtë duke u bazuar në thirrjen për aplikim të parashtruar, fuqia e kapaciteteve financiare të agrobiznesit, si dhe kapacitetet e tyre për t'i menaxhuar veprimet e propozuara siç dëshmojnë në përvojën e paraqitur.

Agrobizneseve që janë në listën e ngushtë, për t'u futur në procesin konkurrues, si rezultat i aplikimit të tyre do t'u kërkohet ta paraqesin një plan të plotë financiar dhe plan biznesi.

Vini re: që vendimi për përfshirjen ose përjashtimin e një agrobiznesi varet vetëm nga cilësia e aplikacionit. Nuk do të ketë asnjë prezantim shtesë për të mbështetur asnjë aplikacion, vetëm nëse MBPZHR-ja kërkon sqarime të mëtejshme. Nëse paraqitet nevoja për sqarime të mëtejshme, pyetjet që do të bëhen do t'u paraqiten të gjitha kompanive, për shkak të transparencës.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka të drejtë që të mos vazhdojë me fazën e dytë, nëse aplikacionet e paraqitura nuk i përmbushin qëllimet e investimit të MBPZHR-së.

2. PROGRAM I VEÇANTË NGRITJA E AFTËSISË KONKURRUESE NË SEKTORIN E BUJQËSISË, PYLLTARISË PËRMES PËRFSHIRJES SË KOMUNITETIT NË ZHVILLIMIN RURAL NË REGJONIN E MITROVICES SË VERIUT

Data e shpalljes: 14 Prill 2018

Data e mbylljes: 30 Maj 2018

1. Profili i sektorit

Zhvillimi i sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë kanë rëndësi të veçantë, si në aspektin e përmirësimit të bilancit tregtar, uljes së papunësisë, sigurisë së produkteve ushqimore, mbrojtjes së ambientit dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve në përgjithësi. Prandaj sektori i bujqësisë mbetet një nga prioritetet kryesore të Qeverisë.

MBPZHR përmes ofrimit të granteve me shumica të vogla ka për qëllim rritjen e aftësisë konkurruese, rritjen e madhësisë së fermave, rritjen e prodhimit të ushqimit të shëndetshëm, përmirësimin e kushteve socio-ekonomike, uljen e kostos së prodhimit, përmirësimin e infrastrukturës rurale, ruajtjen e burimeve natyrore dhe biodiversitetit. Ofrimi i mbështetjes përmes këtyre granteve me shumica të vogla ndikon në sigurimin e të ardhurave të favorshme për fermerët dhe popullatën rurale, promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë, si dhe ruajtjen e resurseve natyrore, mbrojtjen e tokës bujqësore, shfrytëzimin e qëndrueshëm dhe rregullimin e tokës bujqësore.

MBPZHR duhet të zhvillojë më shumë skema të granteve me shumica të vogla për disa arsye:

- **Struktura e fermës** – momentalisht në Kosovë prodhimi bujqësor është i ulët si rezultat i madhësisë së vogël të fermave (1 ha për ekonomi familjare). Fermë e vogël gjithashtu nënkupton se fermerët nuk mund të prodhojnë tepër për qëllime tregtare, prandaj rritja e mbështetjes përmes granteve me shumica të vogla është e domosdoshme që të rritet eksporti dhe të zvogëlohet importi.
- **Besimi** – krijimi i besimit të fermerëve në mbështetjen e shtetit, e cila do të rezultojë në inkurajimin e fermerëve për kultivim të tokave bujqësore dhe rritje të prodhimit bujqësor në të ardhmen.
- **Norma e papunësisë** - Bujqësia dhe pylltaria janë sektor të rëndësishëm ekonomik, të cilët sigurojnë pjesën më të madhe të punësimit në Kosovën e pasluftës, mirëpo prapë norma e papunësisë në Kosovë arrin nivelin e 30 % e cila konsiderohet të jetë një nga normat më të larta në Evropë (10.5 % në vendet e BE-së). Duke marrë parasysh se rreth 62% e popullsisë jeton në zonat rurale dhe se papunësia është më e theksuar në këto zona (gjë që ka ndikuar në krijimin e varfërisë prej 31% dhe 10.7% varfëri ekstreme), mbështetja përmes granteve me shumica të vogla do të luajë rol të rëndësishëm për ofrimin e mundësive për punësim, rritjen e atraktivitetit dhe për krijimin e të ardhurave për njerëzit që jetojnë në zonat rurale.

MBPZHR këtë program do ta ketë në formë rotacioni, ku çdo vit do të jetë rajon i ndryshëm i implementimit.

2 Objektivat strategjike

Objektivat strategjike të kësaj mase janë të ndërlidhura me objektivat strategjike të PBZHR-së 2014-2020 dhe korrespondojnë me:

- Ngritja e punësimit dhe përmirësimi i mirëqenies sociale;
- Ndalimi i migrimit social rural - urban;
- Rritja e prodhimit të produkteve bujqësore dhe pyjore jo drusore;
- Promovimi dhe marketingut dhe i tregjeve për produkteve bujqësore;
- Ngritja e shkathtësisë së fuqisë punëtore;
- Krijimi i vendeve të reja të punës.

Ndërsa objektivat strategjike të kësaj politike janë objektiva komplementare edhe me objektivat e përgjithshme që dalin nga PBZHR 2014 -2020 dhe që mbulojnë disa fusha të strukturuar në 6 komponentë:

- Zhvillimi i njohurive dhe ndryshimeve në bujqësi, pylltari dhe zona rurale;
- Rritja e aftësisë konkurruese në të gjithë sektorët e bujqësisë dhe rritja e qëndrueshmërisë së fermave;
- Promovimi i organizatave të ushqimit dhe menaxhimi i rrezikut në bujqësi;
- Restaurimi, ruajtja dhe përmirësimi i ekosistemeve të varura nga bujqësia dhe Pylltarisë;
- Promovimi i efikasitetit të resurseve;
- Promovimi i përfshirjes sociale, zvogëlimit të varfërisë dhe zhvillimit ekonomik në zona rurale.

3. Kriteret e përbashkëta të pranueshmërisë

Nëse aplikuesi është person fizik, ai duhet të jetë së paku 18 vjeç, që nuk i ka mbushur 61 vjet. Në rastin e ndërmarrjeve ky kriter nuk aplikohet; Personi fizik duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e detyrueshëm elementar (8 ose 9 vjeçar) -Në rastin e ndërmarrjeve, kërkesa e sipërpërmendur vlen për pronarin ose për personin e autorizuar të ndërmarrjes. Personi i autorizuar duhet të ketë kontratë pune së paku edhe për tri vjet; pas momentit të aplikimit; Aplikuesit duhet t'i kenë të shlyera detyrimet tatimore dhe atë, personat fizik, tatimin në pronë, kurse ndërmarrjet, tatimin në të ardhura të korporatave dhe tatimet e tjera të aplikueshme;

3.1. Standardet Kombëtare

Përfituesit nga nën masa e blegtorisë duhet që t'i përmbushin standardet kombëtare për shëndetin e kafshëve, mirëqenien e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit sipas legjislacionit në fuqi.

3.2 Kriteret e tjera të pranueshmërisë

Të gjitha asetet që kanë të bëjnë me investimin (toka, stallat, kafshët, pemishtet etj.) duhet të jenë të regjistruara në Regjistrin e Fermës.

Të gjitha kontratat e qiramarrjes duhet të jenë të motorizuara, përveç kontratave të qiramarrjes me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës (APK) dhe me komuna, të cilat nuk ka nevojë të jenë të noterizuara

Në rast të tokave të marra me qira nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës, kontratat mund të jenë edhe për kohë më të shkurtër se sa është e paraparë për aplikuesit e tjerë. Tokat pyjore (sipas certifikatës së pronësisë) nuk pranohen si tokë bujqësore.

Në rastin e projekteve që parashohin ndërtim apo zgjerim, aplikuesit me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë:

- Certifikata e pronësisë (Fletën poseduese) të parcelës, në të cilën do të bëhet investimi;
- Në rast se toka ose objekti është marrë me qira, kontratën e noterizuar të qirasë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit;
- Kopjen e planit të parcelës ku do të bëhet investimi;
- Kopjen e skicave të objektit;
- Paralogaria e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara;
- Pëlqimin e komunës që dëshmon se në rast të dhënies së grantit, aplikuesi mund të marrë leje ndërtimi;

Përfituesi, para se të bëjë kërkesën për pagesë në MBPZHR, duhet të dorëzojë:

- Lejen për ndërtim nga organi kompetent i Komunës;
- Në rastin e projekteve që parashohin renovim, aplikuesit, me rastin e aplikimit duhet të dorëzojnë parallogaritë e shpenzimeve të materialit dhe të punëve të parapara.

Në rast të ndërtimit, zgjerimit apo renovimit të objekteve, të ngritjes së pemishtes apo vendosjes së sistemit të ujitjes në toka të marra me qira, kontrata për qiramarrje duhet të jetë për së paku 10 vjet duke llogaritur nga viti i aplikimit.

Kontrata duhet të përmbajë edhe pëlqimin e pronarit (qiradhënësit), për investimin që do të bëhet në tokën e tij.

Kontrata për qiramarrje nuk kërkohet vetëm në rastet kur pronari i tokës dhe aplikuesi janë në marrëdhënie bashkëshortore apo në vijë të drejtë të gjakut pa kufij (p.sh.: stërgjyshërit, gjyshërit, prindërit, fëmijët, nipërit, etj.) dhe kjo dëshmohet përmes certifikatës së martesës apo certifikatës së lindjes dhe / apo certifikatës së vdekjes. Po ashtu, aplikuesi duhet të plotësojë Deklaratën nën betim, me të cilën dëshmon se toka me të cilën aplikon është trashëguar nga ai.

4. Kriteret e veçanta të pranueshmërisë

4.1 Sektori i pemëve

Në momentin e aplikimit për investime në sektorin e pemëve, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet të llogaritur nga viti i aplikimit dhe atë së paku 0.10 hektarë për pemë drufrutore (molla, dardha, kumbulla, vishnja, arra, lajthia, qershia, kajsia, pjeshka, ftoni, dredhëza, mjedër, manaferra, boronicë);

Përfituesit për ngritje të pemishteve të reja, para kërkesës për pagesë, nëse blejnë fidanë të prodhuar në Kosovë, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush kriterin CAC (ConformitasAgrariaCommunitatis) dhe kopjen e licencës së prodhuesit, kurse ata që blejnë fidanë të importuar nga vendet e BE-së, duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës fito-sanitare mbi gjendjen shëndetësore të materialit fidanor që përmbush së paku kriterin CAC të lëshuar nga prodhuesi, certifikatën për prejardhjen e origjinës dhe lejen e importit të ndërmarrjes importuese.

Fidanët e mbjellë të pemëve drufrutore duhet të kenë të ngjitur në trup etiketën e institucionit certifikues.

4.2 Sektori i perimeve

Në momentin e aplikimit për investime në depo në nivel të fermës për pemë dhe perime (përfshirë pataten), aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë së paku 1 hektarë sipërfaqe të tokës bujqësore në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 10 vjet.

Fermerët që planifikojnë ndërtimin e serrave duhet të dëshmojnë se kanë tokë të mjaftueshme, së paku 0.10 ha në pronësi apo të marrë me qira për së paku 10 vite.

4.3 Sektori i qumështit dhe mishit

Për investime në sektorin e mishit dhe qumështi (majmëria e viçave dhe derrave, lopëve qumështore), aplikuesit nuk janë të obliguar të kenë viça/derra/lopë në momentin e aplikimit, por para kërkesës për pagesën e fundit duhet të kenë së paku 1-4 krerë viça, ose 5 derra për trashje me matrikuj të Republikës së Kosovës ose të vendeve të BE-së, dhe këto duhet t'i dëshmojnë me dokumente përkatëse dhe me praninë e tyre në stallë, si dhe 1-5 lope qumështore. Aplikantët që aplikojnë për ndërtimin e stallës për viça dhe për derra, në projektin e tyre duhet ta përfshijnë edhe depon e plehut me kapacitet të mjaftueshëm për së paku 3 muaj (shiko listën e standardeve minimale kombëtare). Në rast të investimeve në mekanizim bujqësor për kultivimin e tokës, aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë të paktën 0.5 hektar të tokës bujqësore për çdo krerë lope, respektivisht 0.05 hektar të tokës bujqësore për kokë dele/dhie, derra në pronësi, të trashëguar apo të marrë me qira për së paku 5 vjet.

4.4 Sektori i hurdhave të peshqve

Nuk ka kriteret e veçanta, megjithatë, për investime në këtë sektor aplikuesit duhet të dëshmojnë se kanë sipërfaqe të mjaftueshme tokësore, si dhe kanë eksperiencë në këtë lëmi.

4.5 Sektori i frutave pyjore jo drusore dhe bimëve aromatike

Për investime në këtë sektor pikuesit duhet të dëshmojnë se:

- Kanë pranuar dhe përpunuar çdo vit të paktën 100 kg të frutave të malit, kërpudhave dhe bimëve aromatike dhe mjekësore në 2 vitet e fundit;
- Kanë së paku 1 punëtorë (ekuivalent me punëtorë me orar të plotë);
- Kanë tregtuar të paktën 90% të prodhimit të tyre;
- Të dëshmojnë se kanë paguar të gjitha obligimet (tatimet) ndaj shtetit dhe komunës që i përkasin;
- Të nënshkruajnë një deklaratë me të cilën obligohen se do t'ju përmbahen kriteret e përzgjedhjes edhe tri vjet pas marrjes së pagesës.

5. Investimet e pranueshme

5.1 Sektori i pemëve

- Investimet në ngritjen e pemishteve të reja me sipërfaqe minimale prej 0.10 hektar për pemë drufrutore dhe për pemë manore;
- Investimet në vendosjen e sistemeve të ujitjes në fermë, sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për pemishte, për mbrojtje të bimëve, për plehërim, për vjelje dhe trajtim pas vjeljes;
- Investimet për blerje të traktorit për pemët dru-frutore;
- Për pemët manore blerja e traktorëve është investim i papranueshëm;
- Investimet në ndërtimin dhe përmirësimin e objekteve për aktivitetet e pas vjeljes, objekteve për vendosjen e makinave, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale;
- Investimet në dhoma për ftohje ose frigorifer për pemët manore;

5.2 Sektori i perimeve

- Investimet në ndërtimin e serrave të përhershme për perime, pemë manore apo fidanë. Sipërfaqja minimale e një serre është 0.01 hektarë;
- Blerja dhe instalimi i pajisjeve për arritjen e kushteve të kontrolluara klimatike, përfshirë pajisjet për ngrohje në serra;

- Investimet në vendosjen ose avancimin e sistemeve të ujitjes në serrë sipas praktikave efikase të ujitjes;
- Ndërtimi i objekteve për trajtim pas vjeljes (klasifikim, paketim, etiketim) dhe për ruajtje të prodhimit, si dhe depove për produkte për mbrojtje të bimëve dhe për plehra artificiale;
- Blerja e mekanizmit përkatës për kultivimin e perimeve në fushë të hapur apo në serra (makinë për mbjellje të fidanëve, makinë për shtrirje të folisë.)

5.3 Sektori i qumështit dhe mishit, bletëve

- Ndërtimi/rinovimi/zgjerimi i stallave, objekteve përcjellëse (deponitë e plehut, hangarët e ushqimit voluminoz, depot e silazhit) dhe infrastrukturës në fermë (p.sh. furnizim me ujë në nivel ferme);
- Investimet në pajisje për rritje të zogjve njëditor (pajisje për ngrohje, për ushqim, për furnizim me ujë);
- Investimet në modernizimin e sistemit të ushqimit dhe furnizimit me ujë;
- Investimet në makineri bujqësore dhe pajisje për kultivim të bimëve foragjere dhe drithërave, mbrojtje të bimëve, plehërim dhe korrije;
- Investimet për blerje të traktorit;
- Investimet për pastrimin/largimin e plehut organik (të lëngët dhe të ngurtë) dhe deponimin e tij;
- Investimet për prodhimin e ushqimit të koncentruar,
- Blerja e bagëtime;
- Blerja e koshereve me dhe pa bletë;
- Blerja e makinerisë dhe pajisjeve për prodhimin dhe përpunimin e mjaltit;
- Rimorkio të specializuara për bartjen e koshereve;
- Investimet në pajisje për nxjerrjen e produkteve të bletës;
- Investimet në pajisje për kultivimin e mëmave;
- Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i dhomës së mjaltit;
- Blerja e linjave teknologjike për mbushje dhe paketim të mjaltit;

5.4 Sektori i peshqve

- Ndërtimi i bazenave dhe hurdhave për kultivim të peshqve

5.5 Sektori i frutave pyjore jo drusore dhe bimëve aromatike

- Ndërtimi / rinovimi / zgjerimi i objekteve për ruajtjen, përpunimin dhe paketimin e bimëve mjekuese, frutave pyjore dhe kërpudhave të grumbulluara;
- Blerja e pajisjeve për larje, pastrim, ruajtje, klasifikim dhe përpunim;
- Blerja e pajisjeve për tharje, për ftohje, për ngrirje të thellë, etj.;
- Blerja e rafteve për tharje;
- Blerja e pajisjeve për matje, paketim dhe etiketim;
- Frigoriferët;
- Makina për prerje (grirje)

6. Shpenzimet (kostot) e papranueshme

- Taksat, duke përfshirë tatimin në vlerën e shtuar;
- Taksat doganore dhe të importit, ose ndalesa e tjera;
- Blerja, marrja apo lëshimi me qira i tokës dhe i objekteve ekzistuese;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;
- Pajisjet e dorës së dytë;
- Detyrimet bankare, shpenzimet e garancioneve dhe detyrimet e ngjashme;
- Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes;
- Shpenzimet e bëra para publikimit të procedurës relevante të aplikimit;
- Kontributet e pakthyeshme.

10. Dokumentacioni i nevojshëm:

- Përfituesit e projekteve investuese duhet të dorëzojnë projektin sipas formatit të kërkuar nga MBPZHR si pjesë e aplikacionit. Në rast të punëve të ndërtimit dhe/ose rindërtimit, dokumentacioni teknik me plan të ndërtimit dhe/ose rindërtimit duhet përgatitur dhe dorëzuar bashkë me planin e biznesit;
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës (për personat fizik) ose kopjen e regjistrimit të biznesit (për persona juridik), dokumentin i cili vërteton se kush e ka autoritetin që të nënshkruaj për kompaninë;
- Kopjen e llogarisë së vlefshme bankare;
- Dëshminë kadastrale të sasisë së tokës së bujqësore (ara, livadhe dhe kullota) në posedim ose kopjen e kontratës që dëshmon të drejtën e shfrytëzimit (qira) të sipërfaqes së tokës bujqësore së paku për tri vjet pas aplikimit;
- Lejen e ndërtimit lëshuar nga organi kompetent i komunës;
- Pëlqimin e komunitetit në mjedisin ku planifikohet ndërtimi i stallës dhe
- Dëshminë e vlerësimit të ndikimit mjedisor (vetëm nëse ajo kërkohet me ligj).

11. Shkalla e përkrahjes publike

Shkalla e mbështetjes publike është 90% të vlerës së investimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:203/1
Dt: 13.04.2018

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni4), Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës Ferizaj dhe Sh. M. L. T "11 Marsi" në Prizren për vitin shkollor 2018/2019

Niveli	Institucioni/Shkola	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh M L	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës për Gjuhë Angleze (14 orë);	Vendi i lirë
Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh M L	SHMLT „11 Marsi”	Prizren	Një (1) Instruktor/ e për Dizajin të Veshjes (20 orë)	Vendi i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Nëse punon me orar të plotë nuk ka të drejtë të punojë në ndonjë punë apo detyrë me pagesë nga Buxheti i Kosovës.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor;

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Nëse punon me orar të plotë nuk ka të drejtë të punojë në ndonjë punë apo detyrë me pagesë nga Buxheti i Kosovës.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lart;
- Të ketë më së paku 5 vjet përvojë punë në profesion në ndërmarrje biznese dhe institucione tjera;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë duke punuar në të njëjtin vend të punës.

Aftësitë shtesë

- Nivel të lartë të shkathtësive të komunikimit dhe bashkëpunimit;
- Entuziazëm dhe përkushtim personal në mënyrë që të jetë i dobishëm në zhvillimin e institucionit me cilësi të lartë dhe ndërlidhje me tregun e punës;
- Të jetë mendje-hapur në ide dhe propozime në fushën e LAP-së, gjithashtu të tregojë aftësi kreative/inovative dhe të ketë qasje të qartë për të ardhmen dhe ;
- Plotësisht i besueshëm ndaj institucionit, objektivave dhe vizionit në krijimin dhe drejtimin e QK-së si një institucion që garanton cilësi të lartë, të cilat duhet të jenë parakushtet e mëtejshme.

Procedurat e konkurrit:

Afati i konkurrit është 8 ditë pas shpalljes. Aplikacionet për dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dozohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi në (Qendrën e Kompetencës në Ferizaj , Sh. M. L. 11 Marsi në Prizren) aplikacionet mund të shkarkohen edhe nga ueb-faqen e Agjencisë <http://aaaparr.rks-gov.net/>.

Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë c nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetim dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Në rast të numrit të madh të kërkesave do të ftohen vetëm kandidatët e listës së ngushtë. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Për informata të hollësishme mund të kontaktimi liridona.shala@rks-gov.net nr.tel 038 200 20 198, prej orës 08:00-16:00.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore**

“Parku i Energjisë me Erë –SELAC-1” – Komuna e Mitrovicës së Jugut

Në bazë të Nenit 13.1 të Udhëzimit Administrative nr.16/2014 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Parku i Energjisë me Erë –SELAC-1” – Komuna e Mitrovicës së Jugut**

Nr. prot: 1358/18 të datës 09.03.2018, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda njëzet ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Raporti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore**

“Parku i Energjisë me Erë –SELAC-2” – Komuna e Mitrovicës së Jugut

Në bazë të Nenit 13.1 të Udhëzimit Administrative nr.16/2014 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Parku i Energjisë me Erë –SELAC-2” – Komuna e Mitrovicës së Jugut**

Nr. prot: 1357/18 të datës 09.03.2018, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda njëzet ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Raporti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

**Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore**

“Parku i Energjisë me Erë –SELAC 3” – Komuna e Mitrovicës së Jugut

Në bazë të Nenit 13.1 të Udhëzimit Administrative nr.16/2014 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin **“Parku i Energjisë me Erë –SELAC-3” – Komuna e Mitrovicës së Jugut**

Nr. prot: 1359/18 të datës 09.03.2018, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda njëzet ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Divizioni i Planifikimit Hapësinorë
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Raporti mund të shkarkohet nga linku i mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Suzana Goranci, Udhëheqëse e Divizionit të Planifikimit Hapësinor
Suzana.goranci@rks-gov.net
Telefon: + 381 38 200 32 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Valon Kozhani shpallë të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme në Gjimnazin "Ulpiana" në Lipjan.

► Florent Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën SHMLT "11 Marsi" Prizren

► Getoar Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e vitit X SHMGJ "Gjon Buzuku" Prizren

► Qendresa Oshlani shpall të pavlefshme Indeksën e Fakultetit Ekonomik- drejtimi Banka e Financa në Master.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Fushë Kosovë, për një familje 3 anëtarësh. Banesa duhet të ketë 2 dhoma gjumi, dhomë dite, kuzhinë dhe poashtu të jetë e mobiluar. Banesa kërkohet për afat më të gjatë. Info në tel: 044-741-151

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhome gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një çift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhome gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxejje qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

**URGJENTISHT KËRKOJ BANESË
PËR ZYRE ME QIRA**

Në qendër të Prishtinës, kërkoj banesë me qira, për zyre. Hapësira 80-100m2.

Kati i -I- deri në katin -III-.
Tel: 044741155

Lajmërohen bashkëpronarët e ngatrës kadastrale P-70202016-0440 bk-O, se bashkëpronari Arif Gërxfhalu ka shprehur dëshirën që t'ashen një pjesë të pronës së vet. Andaj njoftohen bashkëpronarët e kësaj parcele kadastrale që nëse janë të interesuar për blerjen e kësaj parcele-pjesën e pronës të lajmërohen te bashkëpronari Arif Gërxfhalu.

LËSHOJ LOKALIN ME QIRA.

Lokali gjendet në rrugën "Isa Kastrioti" në Matiqan të Prishtinës dhe ka një hapësirë prej 400 m2. Lokali është i gatshëm dhe shumë funksional. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të

**Urgjentisht kërkoj një shtëpi
me qira në Prishtinë.
Shtëpia duhet të jetë e
veçantë, duhet të ketë 5
ose 6 dhoma gjumi.
Çmimi sipas marrëveshjes.
Tel 049-472-770**



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage – Ministry for the Kosovo Security Force



BËHU KADET I FSK-së! BËHU OFICER I REPUBLIKËS SË KOSOVËS!

KONKURS

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës shpall konkurs për pranimin e një (1) kadeti në Forcën e Sigurisë i cili do të studiojë në Akademinë Ushtarake, përkatësisht në Universitetin e Zagrebit të Republikës së Kroacisë.

Studimet do të zhvillohen në gjuhën kroate në programin: **Lidershipi dhe Menaxhimi Ushtarak.**
Konkursi do të jetë i hapur prej 16 deri më 24 prill 2018.

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ju shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve për kadetë të FSK-së, pa dallim përkatësie etnike.



Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht.
Aplikacionet mund të dorëzohen në të gjitha kazermat e FSK-së, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00.
Kontaktet: www.mksf-rks.org, 038- 603-355/199.